

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR. 2018 Rep.

NR. 918/1 Kol.



KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS "BOT" (NDËRTIM - OPERIM - TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E "HIDROCENTRALEVE TË LUSËS"

Në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, më datë 14 shtator, viti 2017 (dy mije e shtatëmbëdhjetë), para meje noterit Dhurata Z. Sokol anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Rruga Sani Isakovi, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

MINISTRIA E ENERGISË DHE INDUSTRIËS, që më poshtë do të quhet "AUTORITET KONTRAKTUES", përfaqësuar në bazë të autorizimit nr. 5185/5, datë 1.09.2017, të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetese Z. Agron Gaxho, shtetas shqiptar, i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta me numër ID _____

DHE


SUBJEKTI PËR QËLLIME TË VEÇANTA, SHOQËRIA "IDROLUSA" SHPK., që më poshtë do të quhet "KONCESIONARI", e themeluar nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik, shoqëritë "Idrol Energy" Sh.p.k., dhe "Scotta" S.p.a., në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit Shqiptar, regjistruar më datë 11/08/2017 në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me NUIS L72011006K, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga "Jeronim De Dada", Ndërtesa. 1, Hyrja. 25, Apartamenti. 40, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Z. Sokol MUCEKU, shtetas shqiptar, lindur në MAT më datë _____ madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit _____ (së bashku "Palët" dhe secila veçmas "Pala")

Hyrje

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Shqipërisë:

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistues me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;


- 
2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;
 3. Vlerëson formën e koncesionit “BOT”, si një formë koncesioni që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;
 4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
 5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;
 6. Ka nisur procedurat e tenderimit për dhënien e një koncesioni të formës “BOT” (Ndërtim – Operim - Transferim), për ndërtimin e “Hidrocentralet e Lusës”, në Bashkinë Klos, qarkun e Dibrës, shpallur nga Agjencia e Prokurimit Publik në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 24, datë 19/06/2017 (që më poshtë do të quhen “**PROCEDURA PËRZGJEDHËSE**”) dhe në përfundim të Procedurës Përzgjedhëse konkurruese, ka vlerësuar dhe përzgjedhur bashkimin e operatoreve ekonomik, shoqëritë “Idrol Energy” Sh.p.k. dhe “Scotta” S.p.a., që më poshtë do të quhen “**BASHKIMI I PËRKOSSHËM I OPERATORËVE EKONOMIK**”, si ofertuesi më i suksesshëm për koncesionin objekt të kësaj Kontrate.

Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve të sipërcituara, dhe në përfundim të Procedurës Përzgjedhëse, është vlerësuar si ofertuesi më i suksesshëm;
2. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve përkatëse në pellgun ujëmbledhës të Lusës, nga burimet e tij deri në kутen 500 m m.n.d, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj Kontrate Koncesioni;
4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare;
5. Ka themeluar subjektin për qëllime të veçanta, për zbatimin e objektit të kësaj Kontrate Koncesioni.

Atëherë, Palët lidhin këtë Kontratë Koncesioni (përcaktuar si vijon) bazuar në Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, duke rënë dakord për sa më poshtë:

Përmbajtja



KREU I.....

Neni 1.....

Perkufizime, interpretime.....

Neni 2.....

Objekti i Koncesionit.....

Neni 3.....

Karakteristikat e Hidrocentralit.....

Neni 4.....

Periudha e Koncesionit.....

KREU II.....

Neni 5.....

Të Drejtat Koncesionare - Sheshi.....

Neni 6.....

Monitorimi dhe Mbikëqyrja.....

Neni 7.....

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues.....

KREU III.....

Neni 8.....

Detyrimet e Koncesionarit.....

Neni 9.....

Investimi.....

Neni 10.....

Programi Punimeve.....

Neni 11.....

Komisionimi dhe Vënia në Punë e Veprës.....

Neni 12.....

Mospërmbushjet, Forca Madhore dhe Veprimet Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme.....

Neni 13.....

Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit.....

Neni 14.....



Kontratat	
Neni 15.....	
Sigurimi i Kontratës	
Neni 16.....	
Sigurimi	
Neni 17.....	
Tarifa Koncesionare.....	
Neni 18.....	
Kufizimet.....	
Neni 19.....	
Raportimi.....	
Neni 20.....	
Sanksionet	
Neni 21.....	
Korrigjimi i Shkeljeve	
Neni 22.....	
Transferimi i Aseteve/Dorëzimi	
Neni 23.....	
Përfundimi i Kontratës së Koncesionit.....	
Neni 24.....	
Konfidencialiteti	
Neni 25.....	
Ndryshimet	
Neni 26.....	
Bashkëpunimi Midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.....	
Neni 27.....	
Regjistrimi i Kontratës së Koncesionit.....	
Neni 28.....	
Legjislacioni i Zbatueshëm	
Neni 29.....	
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....	

Aneksi 1

HARTAT E SHESHIT

Aneksi 2

VLERA E INVESTIMIT SIPAS PREVENTIVIT TË PUNIMEVE

Aneksi 3

PROGRAMI I PUNIMEVE DHE AFATET

Aneksi 4

KOMPENSIMI NË RAST ZGJIDHJE

Aneksi 5

SIGURIMI I KONTRATËS



KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME



Neni 1
Përkufizimet, Interpretimi


1.1 Përkufizimet

Kudo që në këtë Kontratë Koncesioni përdoren termat e mëposhtme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon. Termat e tjerë që mund të përkufizohen diku tjetër në këtë Kontratë Koncesioni do të kenë kuptimet që parashikohen në nenet apo ankesat përkatëse të kësaj Kontrate Koncesioni.


- 1.1.1 **Aneks:** është çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga Palët dhe që Palët ja bashkëlidhin kësaj Kontrate Koncesioni, si pjesë përbërëse e saj.
- 1.1.2 **Autoriteti Kontraktues:** është ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë elektrike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë.
- 1.1.3 **Autoritet Publik:** do të thotë (i) Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri ose nënndarje politike e saj; dhe (ii) çdo gjykatë ose çdo entitet tjetër qeveritar, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose (iii) çdo njësi e pushteti vendor, të cilat ushtrojnë juridiksion sipas Ligjit mbi Koncesionarin, ose (iv) çdo autoritet i pavarur rregullator në Republikën e Shqipërisë.
- 1.1.4 **Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik:** do të thotë bashkërisht shoqëritë: (i) "Idrol Energy" Sh.p.k., dhe (ii) "Scotta" S.p.a., të cilët kanë krijuar shoqërinë SPV, "Idrolusa" Sh.p.k., sipas kërkesave të Ligjit për Koncesionet, i ndryshuar dhe me kërkesë të Autoritetit Kontraktues.
- 1.1.5 **Certifikata e Pranimit të Veprës:** do të thotë dokumenti i lëshuar nga Autoriteti Kontraktues për secilin Hidrocentral, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 11.
- 1.1.6 **Data e Hyrjes në Fuqi:** është data në të cilën kjo Kontratë Koncesioni hyn në fuqi, siç përcaktohet në Nenin 4.1 më poshtë.
- 1.1.7 **Data e Mbarimit:** është data e përvjetorit të 35-të të Datës së Hyrjes në Fuqi.
- 1.1.8 **Data e Shtyrë e Mbarimit:** është data që përkon me përfundimin e Periudhës së Pezullimit, në rastet e përcaktuara nga Neni 4.1.2.
- 1.1.9 **Data e Zgjidhjes:** do të thotë data e zgjidhjes paraprake të kësaj Kontrate Koncesioni, në përputhje me kushtet e përcaktuara sipas Nenit 13.



- 1.1.10 **Ditë Pune:** është çdo ditë e javës përveç ditës së Shtunë, të Diele dhe ditëve të tjera të festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.
- 1.1.11 **Enti Rregullator i Energjisë (ERE):** është institucioni i pavarur rregullator i sektorit të energjisë elektrike, që vepron sipas legjislacionit Shqiptar të sektorit të energjisë elektrike.
- 1.1.12 **E Drejta për Kalim:** do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjese të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.13 **Furnizuesi i Shërbimit Universal:** është shoqëria e licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit ekzistues shqiptar për sektorin e energjisë elektrike.
- 1.1.14 **Gëzim i Qetë:** do të thotë e drejta ekskluzive për të përdorur dhe gëzuar Sheshin (duke përfshirë objektet ekzistuese, nëse ka të tilla) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Periudhës së Koncesionit (përcaktuar sipas nenit 4), në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni, pa ndërhyrje të pajustificuara nga Autoriteti Kontraktues, nga ndonjë Autoritet Publik ose nga ndonjë subjekt privat, përveçse në rastet kur përcaktohet ndryshe në këtë Kontratë Koncesioni.
- 1.1.15 **Hidrocentrali/et:** janë bashkërisht të gjitha centralet vijuese të kaskadës së perroit Lusë, nga burimet e tij deri në kuoten 500 mnd, në Bashkinë Klos, qarku Dibër, dhe veçmas secili prej (i) HEC Lusa 1, (ii) HEC Lusa 2, së bashku me tërësinë e aseteve, punimeve dhe makinerive apo pajisjeve të instaluar për prodhimin e energjisë elektrike dhe shfrytëzimin e optimizuar të kaskadës.
- 1.1.16 **Investimi:** është vlera totale monetare sipas preventivit të punimeve paraqitur në ofertën e Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik gjatë Procedurës Përzgjedhëse (një kopje e preventivit të punimeve bashkëlidhet si Aneksi 2), që do të investohet tek Koncesionari, në formën e kapitalit apo të huave, dhe që do të shërbejë për financimin e projektimit, ndërtimin dhe pajisjen e Hidrocentraleve me makineritë e nevojshme, duke përjashtuar këtu për shmangien e dyshimeve, çdo kosto financimi apo kosto të tjera, dhe siç mund të përditësohet në çdo kohë, deri në marrjen nga Koncesionari të lejeve dhe licencave të nevojshme.
- 1.1.17 **Instrument Financiar:** do të thotë çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguruese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e Objektivit të Koncesionit, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
- 1.1.18 **Komisionimi:** është procedura e parashikuar sipas nenit 11 të kësaj Kontrate Koncesioni për marrjen e Certifikatës së Pranimit të Veprës, për secilin nga Hidrocentralet.

- 
- 1.1.19 **Koncesionari:** do të thotë subjekti për qëllime të veçanta, shoqëria "HidroLusa" Sh.p.k., themeluar nga bashkimi i operatoreve ekonomik i zgjedhur si kontraktuesi me i suksesshem, siç identifikohet më sipër në këtë Kontratë Koncesioni.
- 1.1.20 **Kontroll:** do të thotë e drejta për të zgjedhur shumicën e organeve të administrimit (ose të ndonjë organi tjetër të ngjashëm të krijuar) ose ndryshe për të drejtuar menaxhimin dhe politikat e një personi juridik, drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë, qoftë nëpërmjet pronësisë, të drejtave të votës, me anë marrëveshjesh ose në forma të tjera.
- 1.1.21 **Kontratrat:** janë të gjitha kontratat e nënshkuara nga Koncesionari, me kontraktor për realizimin e Punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt shfrytëzimin, operimin e Hidrocentraleve dhe/ose sigurimin e financimit.
- 1.1.22 **Kontrata e Koncesionit ose Kontrata:** është kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që përcaktohet si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj.
- 1.1.23 **Lejet:** do të thotë çdo leje, autorizim, licencë apo miratim, që lëshohet apo ripërtërihet nën përgjegjësinë e Autoriteteve Publike, dhe që është e nevojshme sipas Ligjit për zbatimin e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.24 **Ligj:** do të thotë çdo ligj i zbatueshëm kombëtar ose vendor në Republikën e Shqipërisë, siç është në fuqi në çdo kohë, përfshi këtu çdo urdhëresë, dekret ose rregullore, akt nënligjor ose çdo rregull, kod ose udhëzim, miratuar nga ndonjë Autoritet Publik me juridiksion, në masën që aktet si më sipër rezultojnë të botuara rregullisht dhe të disponueshme publikisht.
- 1.1.25 **Ligji Për Koncesionet:** do të thotë legjislacioni shqiptar mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat, aktualisht Ligji nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" i ndryshuar, siç mund të ndryshohet, shtohet apo zëvendësohet herë pas here.
- 1.1.26 **Mospërmbushjet e Autoritetit Kontraktues:** janë shkeljet nga Autoriteti Kontraktues, të detyrimeve thelbësore ose garancive sipas kësaj Kontrate Koncesioni, që pengojnë thelbësisht, vonojnë apo bëjnë të pamundur zbatimin e Objektivit të Koncesionit nga ana e Koncesionarit.
- 1.1.27 **Mospërmbushjet e Koncesionarit:** janë secila prej ngjarjeve vijuese: - (i) shkelja nga Koncesionari e detyrimeve thelbësore të kësaj Kontrate Koncesioni, që shkakton një efekt thelbësisht negativ në zbatimin e Objektivit të Koncesionit (ii) disponimi i Hidrocentraleve, apo pjesëve të tyre, nga ana e Koncesionarit në kundërshtim me kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni, apo kur ndodh një Ndryshim Kontrolli, pa u marrë miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktues sipas kërkesave të kësaj Kontrate Koncesioni, (iii) braktisja e Punimeve nga ana e Koncesionarit, pa asnjë arsye të justifikuar, për më shumë se 100 (njëqind) ditë të njëpasnjëshme (iv) si dhe çdo shkelje tjetër e kushteve të kësaj kontrate koncesionare dhe legjislacionit në fuqi.

- 1.1.28 **Ndryshim i Kontrollit:** do të thotë transferimi i Kontrollit, nga një palë tek një palë tjetër, e cila nuk është e Palë e Lidhur me palën që transferon kontrollin.
- 1.1.29 **Ngjarje e Forcës Madhore:** do të thotë çdo ngjarje që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate Koncesioni, rrethane e cila është jashtë kontrollit të arsyeshëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Palës së cënuar, që rezulton në ose shkakton një dështim total apo të pjesshëm të Palës së cënuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate Koncesioni (me përjashtim të pagesës së parave), ngjarje të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:(i) akte lufte ose luftë civile (të deklaruara ose jo), konflikte të armatosura ose akte terrorizmi, akte rebelimi, kryengritje, trazira civile, çdo akt sabotimi, bllokadë ose embargo ose (ii) ndotje nukleare, kimike ose biologjike, tërmet, kryengritje dhe trazira civile, (iii) zjarr, shpërthim, rrufe, stuhi, shtrëngatë, përmbytje, rrëshqitje toke, plasje apo derdhje e rezervuarë uji, aparaturash apo tubacionesh, valët e trysnisë të shkaktuara nga mjete që udhëtojnë me shpejtësinë e zërit, rrezatimet jonike, epidemi apo murtajë, (iv) greva politike si dhe greva shtetërore ose jo shtetërore.
- 1.1.30 **Ngjarjet e Zgjidhjes:** do të thotë çdo Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm, i cili mbetet i pakorrigjuar sipas Nenit 12.3, si dhe çdo ngjarje tjetër, e cila, sipas kësaj Kontrate Koncesioni i jep të drejtë një Palë për të zgjidhur këtë Kontratë Koncesioni në përputhje me Nenin 13.
- 1.1.31 **Nisja e punimeve:** është data e nisjes së zbatimit të Punimeve të ndërtimit, sipas Nenit 10.1 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.32 **Objekti i Koncesionit:** do të thotë financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, shfrytëzimi, mirëmbajtja e Hidrocentraleve dhe transferimi i tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni.
- 1.1.33 **Operimi:** do të thotë tërësia e veprimeve të Koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.34 **Palë Financuese:** do të thotë çdo institucion financiar i licencuar si i tillë, pa përjashtuar entitet private, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e Objektivit të Koncesionit.
- 1.1.35 **Palë e Tretë:** është çdo palë e ndryshme nga Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari.
- 1.1.36 **Palë të Lidhura:** janë dy persona mes të cilëve ekziston, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, një marrëdhënie Kontrolli, dhe/ose dy a më shumë persona juridik, të cilët kontrollohen, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nga i njëjti person juridik/individ.

- 
- 1.1.37 **Periudha e Koncesionit:** do të thotë afati i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.38 **Periudhe Pezullimi:** do të thotë periudha e pezullimit automatik të Periudhës së Koncesionit, në rastet e parashikuara sipas Nenit 4.1.2.
- 1.1.39 **Praktika e Mirë e Industrisë:** do të thotë, në çdo kohë, ushtrimi në masën e duhur të aftësisë, kujdesit dhe parashikimit që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme në atë kohë, nga një person i aftë dhe me përvojë që kërkon, në mirëbesim, të përmbushë detyrimet e tij kontraktore, duke vepruar në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi, dhe që angazhohet në të njëjtin lloj aktiviteti, dhe në rrethana dhe kushte të njëjta ose të ngjashme.
- 1.1.40 **Procedura Përzgjedhëse:** do të thotë procedura për dhënien me koncesion të Ndërtimit e Hidrocentralit të Lusës”, siç identifikohet në hyrjen e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.41 **Punimet:** janë tërësia e veprimeve për projektimin, ndërtimin, komisionimin dhe vënien në punë të Hidrocentraleve, në përputhje me projektin e zbatimit.
- 1.1.42 **Regjistri i Pasurive të Paluajtshme:** do të thotë zyra(t) vendore të/e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) që ka juridiksionin territorial në zonën e Sheshit të identifikuar sipas nenit 5.
- 1.1.43 **Sheshi:** do të thotë sipërfaqet ku do të ndërtohen objektet e Hidrocentraleve, përfshi këtu sipërfaqet e nevojshme për Punimet e përkohshme (pjesë të projektit) si dhe sipërfaqe të tjera që janë të nevojshme për zbatimin e projektit, siç identifikohen në hartat e bashkëlidhura si Aneksi 1.
- 1.1.44 **Sigurimi i Kontratës:** është vlera monetare e instrumentit financiar të sigurisë, lëshuar nga një bankë apo nga një shoqëri sigurimesh e licensuar në Republikën e Shqipërisë, që siguron interesat e Autoritetit Kontraktues, sipas nenit 15, në rastet e shkeljes së kushteve të kësaj Kontrate Koncesioni nga ana e Koncesionarit.
- 1.1.45 **Skema Mbështetëse e Trajtimit të Energjisë së Prodhuar:** do të thotë skema e mbështetjes financiare që zbatohet aktualisht në lidhje me energjinë elektrike të prodhuar nga “burime të rinovueshme”
- 1.1.46 **Tarifa Koncesionare:** është kompensimi monetar që Koncesionari paguan në formën e lëvrimit të energjisë elektrike pa pagesë, në sasi të dhe mënyrat e përcaktuara sipas nenit 17 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.47 **Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm:** do të thotë secila nga ngjarjet e mëposhtme (i) shpronësimi, konfiskimi apo sekuestrimi, ose masa të tjera me efekt të njëjtë, i Hidrocentraleve, apo pjesëve të tyre, ose i të Drejtave Koncesionare apo të vetë Koncesionarit, nga ana e Autoritetit Kontraktues ose nga ana e ndonjë autoriteti tjetër publik (jo privat), (ii) dështimi ose vonesë nga

Autoritetet Publike në dhënien e Lejeve të kërkuara nga Ligji ndërkohë që koncesionari ka aplikuar për pajisjen me këto leje në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ose (iii) dështimi apo vonesa e operatorëve të rrjetit për të lidhur Hidrocentralet në rrjetin kombëtar të energjisë, sipas kërkesave të Ligjit, në kushtet e parashikuara nga kjo Kontratë Koncesioni.

1.2 Interpretimi

1.2.1 Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë Koncesioni:

- (a) Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- (b) Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjënjë;
- (c) Çdo frazë që fillon me fjalët “*duke përfshirë*”, “*përfshin*”, “*në veçanti*”, “*për shembull*” e të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
- (d) Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën paragrafët, Aneksat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi në interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni;
- (e) Referimet në dispozitat dhe Aneksat janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe aneksat e kësaj Kontrate Koncesioni;

1.2.2 Kur afati është caktuar me “*ditë*”, afati do të llogaritet në ditë kalendarike, përveçse kur përcaktohet shprehimisht në Ditë Pune. Një afat prej një ose më shumë ditësh kalendarike ose Ditësh Pune do të nisë të llogaritet duke u nisur nga dita kalendarike ose Dita e Punës në të cilën ndodh ngjarja.

1.2.3 Kur afati është caktuar me “*javë*”, “*muaj*” ose “*vite*”, atëherë afati do të llogaritet nga data në datë (“*data korresponduese*”); kur afati është caktuar në “*muaj*”, nëse muaji i fundit kalendarik i periudhës përkatëse nuk ka një datë korresponduese, të ditës së muajit kalendarik kur fillon afati, atëherë afati do të përfundojë në ditën e fundit kalendarike të muajit të fundit kalendarik të periudhës.

1.2.4 Në rast mospërputhje midis çdo termi të përcaktuar sipas nenit 1.1 dhe një ndonjë përkufizimi tjetër në ndonjë parashikim tjetër të kësaj Kontrate Koncesioni, Aneksi apo shtojcë të ndonjë aneksi të kësaj Kontrate Koncesioni, atëherë, kuptimi i dhënë në nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo parashikim tjetër të kësaj Kontrate Koncesioni, Aneksi apo shtojcë të ndonjë aneksi të kësaj Kontrate Koncesioni.

Neni 2 Objekti i Koncesionit

2.1 Në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Koncesioni, Autoriteti Kontraktues, në bazë të Ligjit të Koncesioneve, i jep Koncesionarit të drejtat koncesionare sipas nenit 5, për zbatimin e Objektivit të Koncesionit, të formës BOT (që do të thotë ndërtimin, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së Koncesionit), si vijon:

- *financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen e Hidrocentraleve dhe transferimin e tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni.*

Neni 3 Karakteristikat e Hidrocentralit

3.1 Kaskada e hidrocentraleve mbi përroin e Lusës përbëhet nga: (i) HEC Lusa 1, dhe (ii) HEC Lusa 2, të cilët do të shfrytëzojnë potencialin hidroenergjetik të pellgut ujëmbledhës të lumit të Lusës, nga burimet e tij deri në kuotën 500 m m.n.d, në Bashkinë Klos, Qarku Dibër dhe do të kenë karakteristikat teknike vijuese:

Hidrocentrali “Lusa 1”

- Kuotat e veprave
- Kuota e veprës së marrjes 1750 m m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit 1103 m m.n.d.
- Fuqia e instaluar (kW) $N = 1\ 580\ \text{kW}$.
- Energjia mesatare vjetore kWh $E = 5\ 754\ 289\ \text{kWh/vit}$.

Hidrocentrali “Lusa 2”

- Kuotat e veprave
- Kuota e veprës së marrjes 1100 m m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit 500 m m.n.d.
- Fuqia e instaluar (kW) $N = 4\ 800\ \text{kW}$.
- Energjia mesatare vjetore kWh $E = 16\ 879\ 977\ \text{kWh/vit}$.

Parametrat hidroenergjetikë totalë do të jenë:

- **Fuqia e instaluar: $N = 6\ 380\ \text{kW}$**
- **Energjia mesatare vjetore: $E = 22\ 634\ 266\ \text{kWh}$**

3.2 Karakteristikat teknike mund të pësojnë ndryshime të mundshme, në marrëveshje ndërmjet Palëve në variantin përfundimtar të projekt-zbatimit të Hidrocentraleve.

Neni 4 Periudha e Koncesionit



4.1 Hyrja në fuqi

4.1.1 Kjo Kontratë Koncesioni dhe të drejtat e detyrimeve të Paleve do të hynë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët ("**Data e Hyrjes në Fuqi**") dhe do të mbetet në vijim në fuqi dhe me efekte të plota deri në Datën e Mbarimit (d.m.th. përvjetori i 35-të i Datës së Hyrjes në Fuqi), apo në Datën e Shtyrë të Mbarimit, në rastet e parashikuara sipas nenit 4.1.2 këtu më poshtë, përveçse kur kjo Kontratë Koncesioni zgjidhet sipas parashikimeve të nenit 13, dhe në këtë rast afati përfundon në Datën e Zgjidhjes.

4.1.2 Palët bien dakord se, në rast të një Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues, të një Ngjarje të Forcës Madhore ose të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, të njoftuar nga Koncesionari në përputhje me nenin 12.2 dhe/ose 12.3, do të shkaktojë pezullimin automatik të llogaritjes së Periudhës së Koncesionit për një afat që i korrespondon periudhës së ngjarjes së Forcës Madhore ose të Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm gjatë të cilës Koncesionari është i pamundur apo vonohet, në përmbushjen e kësaj Kontrate Koncesioni (përfshi këtu kohën e arsyeshme dhe të nevojshme për të riparuar dëmet ne marreveshje mes paleve) për shkak të ndodhjes së kësaj Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues, Ngjarje të Forcës Madhore ose Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm ("**Periudha e Pezullimit**"); Njoftimi me shkrim i pezullimit dërguar nga Koncesionari, duhet të përmbajë një përshkrim të rrethanave dhe një parashikim të kohëzgjatjes së Periudhës së Pezullimit, nëse një parashikim i tillë është i mundur. Periudha e Koncesionit do të rinisë me njoftimin me shkrim të Autoritetit Kontraktues drejtuar koncesionarit pasi Ngjarja e Forcës Madhore ose Veprimi Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm nuk shkakton më pamundësi apo vonesa për Koncesionarin, dhe/ose kur Koncesionari të ketë riparuar dëmet ne marreveshje mes paleve, me kusht që Koncesionari, gjatë Periudhës së Pezullimit, do të jetë i detyruar të marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të reduktuar efektet e pezullimit mbi aftësitë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Kontrate Koncesioni, dhe për të mundësuar rifillimin e llogaritjes së Periudhës së Koncesionit, sa më shpejt të jetë e mundur, me përjashtim të rastit kur kjo Ngjarje e Forcës Madhore ose Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm shkakton një Ngjarje Zgjidhje.

4.2 Zgjatja e Periudhës së Koncesionit pas Datës së Mbarimit apo Datës së Shtyrë të Mbarimit

4.2.1 Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit mund të zgjatet nëse është e nevojshme, duke u bazuar në një marrëveshje tjetër, në përputhje me parashikimet e Ligjit të Koncesioneve, në përputhje me kohën e përshtatshme për të konsideruar projektin fitimprurës dhe financiarisht të përshtatshëm, në përputhje me analizën financiare të "vlerës për para", "IRR" ose çdo analizë tjetër të përshtatshme për këtë vlerësim.

KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5
Të Drejtat Konçesionare – Sheshi



5.1 Dhënia e të Drejtave Koncesionare


5.1.1 Duke nisur nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit për të gjithë Periudhën e Koncesionit, i cili pranon, të drejtën:

- (a) të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të operojë, shfrytëzojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralet, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë Koncesioni;
- (b) të përdorë burimet ujore të Lumit Lusë për realizimin e Objektivit të Koncesionit, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni, dhe duke respektuar kushtet mjedisore dhe rrjedhën ekologjike sipas Lejeve;
- (c) të përdorë, pa pagesë, tokën dhe asetet publike në Shesh, përfshi zhavorrin dhe materialet e tjera të nevojshme, pa kërkuar Leje të tjera shtesë, për qëllime të zbatimit të Objektivit të Koncesionit.
- (d) të marrë Sheshin, për të patur të Drejtën e Kalimit dhe Gëzimin e Qetë, siç parashikohen nga Neni 5.2;
- (e) të aplikojë, me diskrecionin e tij të vetëm, për çdo skemë mbështetje të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, në përputhje me Ligjin Nr. 7/2017, datë 2.2.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, siç mund të ndryshohet, shtohet apo zëvendësohet herë pas here.
- (f) me mbarimin e Periudhës së Koncesionit t’i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t’i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentraleve dhe të objekteve ekzistuese (nëse ka) të cilat të jenë në gjëndje të mire pune, si dhe, në çdo rast, të kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjidhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së bashku me të **“Drejtat Koncesionare”**);
- (g) Koncesionari do të ketë të drejtën ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet (perftohet) nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në certifikatat Certified Emission Reductions (CER).

5.2 Dhënia e Sheshit

5.2.1 Pa vonesa pas Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, Autoriteti Kontraktues do t’i japë Koncesionarit të drejtën e Sheshit, të Drejtën e Kalimit dhe do t’i garantojë Gëzimin e Qetë, me të vetmin kusht që Koncesionari t’i ketë paraqitur Autoriteti Kontraktues, kopje autentike të certifikatave të sigurimit, të

cilat vërtetojnë (në masën e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues), se Konçesionari është i pajisur me të gjitha pajisjet e sigurimit dhe garancitë e kërkuara për këtë qëllim, në përputhje me nenin 10 të kësaj Kontrate Koncesioni.




- 5.2.2 Në këtë kuadër, dhe pa cenuar detyrimet e tij kontraktore Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit në marrëdhëniet me Palë të Treta, në mënyrë që të shmanget çdo pengesë, që mund të haset në kuadër të shpronësimeve apo çdo lloji tjetër pengese, në lidhje me titujt përkatës të përdorimit të tokës/aseteve publike, për t'i siguruar Koncesionarit të Drejtën e Kalimit dhe Gëzimin e Qetë të Sheshit, për realizimin e punimeve dhe operimin normal të Hidrocentraleve. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm, kur moszgjidhja e pengesave të mësipërme, vjen si rezultat i mos përmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse, për shkak të veprimeve të fajshme të Koncesionarit.
- 5.2.3 Palët bien dakord që nëse i gjithë Sheshi apo pjesë e tij, është pronë private, dhe Koncesionari, pavarësisht përpjekjeve të arsyeshme, nuk ka arritur të merret vesh me pronarët private, në terma të arsyeshëm, për fitimin e të drejtave të përshtatshme të përdorimit me qëllim zbatimin e Objektivit të Koncesionit, atëherë Koncesionari ka të drejtë të kërkojë shpronësimin për interes publik sipas ligjit, të pasurive private që mund të përfshihen në Shesh, me kusht që Koncesionari të përballojë të gjitha kompensimet, kostot dhe shpenzimet e lidhura me shpronësimet, në përputhje me ligjin.
- 5.2.4 Palët bien gjithashtu dakord që nëse i gjithë apo pjesë e tokës apo asetëve publike të Sheshit, nuk janë në pronësi/administrim të Autoritetit Kontraktues, atëherë Autoriteti Kontraktues do të asistojë Koncesionarin në marrjen, nga autoriteti publik përkatës që ka në pronësi/administrim tokën/asetin, e një titulli të vlefshëm përdorimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.
- 5.2.5 Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës së Kalimit, garantimin e Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujin e lumit të Lusës, Koncesionari e pranon Sheshin "siç është" që nga data e një dhënieje të tillë. Pa cenuar parashikimet e mësipërme, Autoriteti Kontraktues do të mbrojë Koncesionarin nga çdo pretendim i ndonjë Pale të Tretë ndaj Koncesionarit, në lidhje me pronat publike që përbëjnë Sheshin.

5.3 Skema Mbështetëse Për Trajtimin e Energjisë së Prodhuar

- 5.3.1 Koncesionari, nëse dëshiron, mund të zgjedh të përfitojë nga skema e mbështetjes, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe procedurave të miratuara nga ERE.
- 5.3.2 Autoriteti Kontraktues, garanton Koncesionarin se me kryerjen e procedurave të komisionimit dhe vënies në punë të veprës të parashikuar nga neni 11, qofte, edhe të njërit prej Hidrocentraleve, brenda datës 31 dhjetor 2020, apo brenda datës së mëvonshme, që mund të parashikohet nëpërmjet ndonjë shtyrje të afatit të cilësuar

ne nenin 22(1) të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, do të zbatohet blerja e energjisë, ndaj të gjitha Hidrocentraleve, te vene ne pune brenda këtyre afateve, për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh.



5.4 Hidrocentralet në rrjedhën e sipërme

- 5.4.1 Palët gjithashtu shprehimisht bien dakord se, dhe Autoriteti Kontraktues garanton Koncesionarin se, në atë masë që, Autoriteti Kontraktues, apo ndonjë Autoritet Publik tjetër, ka dhënë ose do të japë ndonjë të drejtë një Pale të Tretë për të kontrolluar, shfrytëzuar, devijuar ose shkarkuar rezervat ujore në pjesën e sipërme të Sheshit (“**Hidrocentralet në Rrjedhën e Sipërme**”), (i) ndërtimi dhe operimi i këtyre Hidrocentraleve në Rrjedhën e Sipërme nuk do të zvogëlojë prurjet ditore që do të kishin ardhur në Hidrocentrale, sipas rrjedhës natyrale; (ii) regjimi operacional i këtyre Hidrocentraleve në Rrjedhën e Sipërme nuk do të ndikojë negativisht në operacionet e Hidrocentraleve.
- 5.4.2 Autoriteti Kontraktues do të mbrojë dhe do të mbajë Koncesionarin të pacënuar nga çdo dhe të gjitha humbjet e shkaktuara si me siper dhe merr masa per rregullimin e shkëlqeve brenda 90 ditëve. Në rast të kundërt Koncesionari gëzon të drejtën të ushtrojë zgjidhje në përputhje me nenin 13.2 të kësaj Kontrate Koncesioni.

5.5 E drejta e shitjes

- 5.5.1 Koncesionari do të ketë të drejtë, me diskrecionin e tij të vetëm, nese heq dore nga skema mbeshtetese sipas ligjit nr.7/2017, date 02.02.2017 “Per nxitjen e përdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme”, të shesë një pjesë apo të gjithë energjinë e prodhuar prej Hidrocentraleve, duke përfshirë këtu të drejtën për të përfituar certifikata të gjelbra, apo ndonjë incentivë tjetër mjedisore, në lidhje me prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, duke marrë në konsideratë gjithashtu parashikimet e nenit 17.

Neni 6 Mbikëqyrja dhe Monitorimi

6.1 Mbikëqyrja e Përgjithshme dhe Monitorimi

- 6.1.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë Periudhës së Koncesionit, nëpërmjet personave të autorizuar, e me shpenzimet e veta, të mbikëqyrë zbatimin e punimeve të ndërtimit, të monitorojë progresin e zbatimit të Objektivit të Koncesionit dhe të verifikojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë Koncesioni, në të gjitha fazat e zbatimit të saj.
- 6.1.2 Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë mbikëqyrje të përgjithshme dhe monitorim në çdo kohë, në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin nga ana e Koncesionarit, të

detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate Koncesioni. Rezultatet e monitorimit do t'i bëhen të njohura Koncesionarit, me shkrim.




- 6.1.3 Në rast se gjatë veprimtarisë së mbikëqyrjes së përgjithshme dhe monitorimit, Autoriteti Kontraktues vëren shkelje të Kontratës së Koncesionit nga ana e Koncesionarit, atëherë Koncesionari do të njoftohet me shkrim, dhe Autoriteti Kontraktues do të propozojë masa korrigjuese dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Përtej detyrimeve të marra përsipër diku tjetër në këtë Kontratë Koncesioni, Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- 7.1 Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj Kontrate Koncesioni, pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.
- 7.2 Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj veprë. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licencë, autorizim, vjen si rezultat i mospërmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.
- 7.3 Të miratojë projektin e zbatimit të Hidrocentraleve, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me ofertën e paraqitur gjatë Procedurës Përzgjedhëse nga Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik (ose të ndryshuar me marrëveshje mes Palëve).
- 7.4 Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike/operatorë të sektorit elektroenergjetik, për qëllime të realizimit të Objektivit të Koncesionit.
- 7.5 T'i garantojë Koncesionarit të Drejtat Koncesionare të parashikuara në nenin 5, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Koncesionit.
- 7.6 Të garantojë Koncesionarin së ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë negativisht në interesat e Koncesionarit, bazuar në këtë Kontratë Koncesioni.
- 7.7 Të mbeshtese koncesionarin për lidhjen e Hidrocentraleve me rrjetin kombëtar të transmetimit të energjisë, në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 7.8 Të garantojë Koncesionarin për blerjen e të gjithë prodhimit të energjisë elektrike të Hidrocentraleve nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Kontrate Koncesionit dhe legjislacionit në fuqi.

- 
- 7.9 Të garantojë Koncesionarin për përmbushjen, pa vonesa, të çdo detyrimi të lidhur me kompensimin e Koncesionarit, në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 7.10 Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, merr përsipër procedurën e shpronësimit për tokën prone private (nëse ka), e cila do të shfrytëzohet për ndërtimin e Hidrocentraleve, me kusht që Koncesionari të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore për këtë shpronësim, si dhe të paguajë shpenzimet e shpronësimit.
- 7.11 Autoriteti Kontraktues merr përsipër të mbështesë Koncesionarin për lidhjen e centralit me Rrjetin Elektrik Kombëtar në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të gjithë kapacitetin e instaluar të përcaktuar në këtë kontrate.

KREU III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONÇESIONARIT

Neni 8 Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe Objektin e Koncesionit, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Koncesioni.

Në veçanti, Koncesionari duhet:

- 8.1 Të ketë paraqitur, brenda 6 (gjashtë) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, për miratim pranë Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit për të gjithë Hidrocentralet.
- 8.2 Të pajiset në përputhje me Ligjin, me të gjitha Lejet e nevojshme për realizimin e kësaj Kontrate Koncesioni;
- 8.3 Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 3 bashkëlidhur kësaj Kontrate Koncesioni, siç mund të përditësohet kohë pas kohe;
- 8.4 Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara ne Aneksin 3 dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë Koncesioni;
- 8.5 Të zbatojë projektin për ndërtimin e Hidrocentraleve, me fuqi totale të instaluar prej jo më pak se 6,380 (gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë) kW;
- 8.6 Të administrojë projektin për Periudhën e Koncesionit;
- 8.7 Të marrë masat e nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe rehabilitimin e çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga Punimet e kryera gjatë ndërtimit dhe funksionimit të

Hidrocentraleve, për kthimin e tij, me shpenzimet e veta, në gjendjen në përparshme sipas detyrimeve të përcaktuara nga Lejet;



- 8.8 Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo Palëve të Treta;
- 8.9 Të mbajë te informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e Punimeve;
- 8.10 Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjenës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë;
- 8.11 Të mos ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës, sipas miratimit të marrë nga institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve të përdorimit të Ujit. Koncesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit të përcaktuar si rrjedhë ekologjike në shtratin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi sipas miratimit të marrë nga institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve të përdorimit të Ujit. Koncesionari duhet të sigurojë ujin e nevojshëm për vaditje, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjislacionin në fuqi;
- 8.12 Të zbatojë Ligjin në veprimtarinë e tij për implementimin e Objektivit të Koncesionit;
- 8.13 Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9 Investimi

- 9.1 Mbi bazën e të dhënave të studimit të fizibilitetit, investimet që parashikohen të kryhen nga Koncesionari janë në vlerën totale prej 621 368 362 (gjashtë qind e njëzetënjë milion e treqind gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind gjashtëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH, siç detajohet në preventivin bashkëlidhur si Aneksi 2. Ky preventiv përfshin edhe vlerën që do të investohen në makineri e pajisje.
- 9.2 Vlera e mësipërme mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet Palëve:
 - pas variantit përfundimtar të projektit të zbatimit, i cili mund të përmirësohet me kushtin që vlera nuk do të jetë me e ulët se ajo e përcaktuar në pikën 9.1 të këtij neni.
 - në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e Hidrocentraleve;
- 9.3 Vlerësimi i investimit do të bëhet mbi bazën e situacioneve tre mujore, të konfirmuara nga një supervisor i pavarur i zgjedhur nga Koncesionari, dhe i konfirmuar nga Autoriteti

Kontraktues. Situacionet do të jenë të depozituara/deklaruara në organet tatimore sipas ligjit.

Neni 10 Programi Punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të Punimeve:

- 10.1 Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 55 ditëve nga data e pajisjes me te gjitha lejet e nevojshme për fillimin e punimeve te ndërtimit. Fillimi i punimeve do të vërtetohet nëpërmjet një procesverbali të nënshkruar mes palëve. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk merr pjesë në nënshkrimin e këtij procesverbali, atëherë Koncesionari i njofton Autoritetit Kontraktues nisjen e punimeve;
- 10.2 Brenda kuadrit të zbatimit të Punimeve për realizimin e projektit (ligji nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, siç mund të ndryshohet, dhe akteve përkatëse nënligjore, siç mund të shtohen apo zëvendësohen herë pas here), Koncesionari do të caktojë një subjekt në rolin e mbikëqyrësit të Punimeve, i cili do te konfirmohet nga Autoriteti Kontraktues. Ky subjekt mund të jetë një person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
- 10.3 Koncesionari merr përsipër të realizojë Punimet në përputhje me Programin e Punimeve të parashikuar nga Aneksi 3 i kësaj Kontrate Koncesioni.
- 10.4 Palët bien dakord se afati i punimeve do të zgjatet në rastet kur ndodhin Mospërmbushje të Autoritetit Kontraktues, Ngjarje të Forcës Madhore ose Veprime Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme, për një periudhë të njëjtë me Periudhën e Pezullimit të parashikuar nga neni 4.1.2 i kësaj Kontrate Koncesioni.

Neni 11 Komisionimi dhe Vënia në Punë e Veprës

- 11.1 Me përfundimin e punimeve në çdo Hidrocentral, Koncesionari njofton Autoritetin Kontraktues lidhur me situatën dhe kërkon nga ky i fundit pjesëmarrjen në kryerjen e testimit për plotësimin e parametrave teknike sipas Nenit 3 të kësaj Kontrate Koncesioni. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues ose te autorizuarit prej tij dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për plotësimin e parametrave të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 11.2 Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, për secilin Hidrocentral, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

- 11.3 Në përfundim të etapave të mësipërme, Autoriteti Kontraktues duhet të nënshkruajë Certifikatën e Pranimit të Veprës për çdo Hidrocentral, e cila do të konsiderohet e dhënë nëse ky i fundit nuk përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga testimi dhe vënia në punë e secilit Hidrocentral.
- 11.4 Me nënshkrimin e Certifikatës së Pranimit të Veprës për të paktën të njërit prej Hidrocentraleve, apo me kalimin e këtij afati prej 30 (tridhjetë) diteve, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontratën e shit-blerjes së energjisë me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

KREU IV TË NDRYSHME

Neni 12

Mospërbushjet, Forca Madhore dhe Veprimet Shtetërore Thelbësishtë Dëmshme


12.1 Ngjarjet e Mospërbushjes

12.1.1 Në rast të një Mospërbushje nga Koncesionari ose të një Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktues, Koncesionari ose Autoriteti Kontraktues, sipas rastit, do t'i paraqesë Palës tjetër ("**Pala në Mospërmushje**") një njoftim me shkrim duke kërkuar korrigjimin, brenda një afati të arsyeshëm nëse ai është i mundur. Dështimi nga Pala në mospërbushje për ta korrigjuar atë brenda afatit të korrigjimit, do të përbëjë një Ngjarje Zgjidhje sipas kësaj Kontrate Koncesioni.

12.1.2 Në rast të ndonjë Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues, në rast se Koncesionarit i shkaktohet vonese, afati për realizim nën përgjegjësinë e Koncesionarit do të shtyhet me aq kohë sa në mënyrë të arsyeshme do të jetë e nevojshme lidhur me këtë Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktues (duke patur parasysh pasojat e mundshme të vonesës). Gjate kësaj periudhe Koncesionari do të çlirohet nga përgjegjësia për përbushjen e të gjitha detyrimeve që pengohen nga këto Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues.

12.2 Ngjarjet e Forcës Madhore

12.2.1 Palët bien dakord që ato nuk do të kenë të drejtë të ngrenë pretendime për mospërbushje kontraktore sipas kësaj Kontrate Koncesioni ndaj Palës tjetër, apo të pretendojnë dëmshpërblim nga Pala tjetër për humbjet e pësuar, për aq kohë sa këto shkaktohen nga një Ngjarje e Forcës Madhore. Pala përkatëse që nuk mund të përbushë detyrimet e saj për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore, duhet të njoftojë me shkrim Palën tjetër, pa vonesë. Në vijim të ndonjë Ngjarjeje të Forcës Madhore, të dyja Palët do të bëjnë çfarë është e mundur, në mënyrë të arsyeshme, për të parandaluar rritjen apo për të reduktuar pasojat e Ngjarjes së Forcës Madhore, dhe Koncesionari, gjatë gjithë kohës së Ngjarjes së Forcës Madhore, apo pasojave të saj, do të ndërmarrë të gjitha hapat sipas kushteve të rëna dakord të Praktikave të Mira të Industrisë, për të tejkaluar apo minimizuar pasojat e Ngjarjes së Forcës Madhore.



12.2.2 Nëse një Ngjarje e Forcës Madhore ose pasojat e saj, vazhdojnë për një periudhë më të gjatë se 3 muaj, duke bërë të pamundur për Palët prekur të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate Koncesioni, atëherë, kjo do të përbëjë një Ngjarje Zgjidhje, të ushtrueshme nga secila Palë sipas nenit 13.3 të kësaj Kontrate Koncesioni.

12.3 Veprimet Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme

12.3.1 Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga ngjarja e një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktues dhe Autoriteti Kontraktues do të sigurojë korrigjimin e Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm në fjalë.

12.3.2 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk do të korrigjojë Veprimin Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm përpara përfundimit të një periudhe prej 90 ditësh nga njoftimi me shkrim i Koncesionarit, Palët do të diskutojnë pa vonesë me qëllim arritjen e një zgjidhje të kënaqshme për të dyja palët për të rivendosur Koncesionarin në pozitën që do të ishte nëse ky Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm të mos kishte ndodhur. Dështimi nga Autoriteti Kontraktues për të korrigjuar apo rivendosur Koncesionarin në pozicionin e mëparshëm, brenda këtij afati (ose nëse Autoriteti Kontraktues ka dështuar apo refuzuar të diskutojë), do të përbëjë një Ngjarje Zgjidhje, të ushtrueshme nga Koncesionari në përputhje me nenin 13.2. Gjate kësaj periudhe Koncesionari do të çlirohet nga përgjegjësia për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që pengohen nga këto Veprime Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme.

Neni 13

Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

13.1 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës së Koncesionit nga Autoriteti Kontraktues, për shkak të Mospërmbushjes së detyrimeve nga Koncesionari.

13.1.1 Autoriteti Kontraktues mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni, për shkak të Mospërmbushjeve të Koncesionarit, të cilat nuk janë korrigjuar brenda një afati 3 (tre muaj), ose një afati tjetër të rene dakord mes Palëve, apo kur Mospërmbushjet e Koncesionarit nuk mund të korrigjohen. Autoriteti Kontraktues nuk mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni në rastet kur ka zbatuar një sanksion, siç parashikohet nga neni 20, dhe sanksioni është shlyer rregullisht nga Koncesionari.

13.1.2 Në rastet e nenit 13.1.1 me sipër, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të njoftojë Koncesionarin dhe Palët Financuese, siç parashikohet në nenin 13.5 për qëllimin e tij për të zgjidhur kontratën, duke i dhënë një afat 60 (gjashtëdhjetë) ditor. Nëse Palët Financuese, brenda këtij afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor, nuk veprojnë në përputhje me të drejtat e tyre, atëherë Autoriteti Kontraktues do të njoftojë zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni, me efekt 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit të këtij njoftimi.

- 13.1.3 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, Koncesionari ka të drejtë për kompensimin e parashikuar në Aneksi 4a, pa cenuar këtu të drejtën e Autoritetit Kontraktues për të ekzekutuar punën e Kontratës, siç parashikohet nga neni 15.
- 13.1.4 Pas Datës së Zgjidhjes për shkak të Mospërmbushjeve të Koncesionarit, Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralet, në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 22.
- 13.2 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës së Koncesionit nga Koncesionari, për shkak të Mospërmbushjeve të Autoritetit Kontraktues apo të një Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm
- 13.2.1 Koncesionari mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni për shkak të Mospërmbushjeve të Autoritetit Kontraktues të cilat nuk janë korrigjuar brenda një afati 3 (tre mujor), ose një afati tjetër të rene dakord mes Palëve, apo kur Mospërmbushjet e Autoritetit Kontraktues nuk mund të korrigjohen. Koncesionari mund të zgjidhë gjithashtu këtë Kontratë Koncesioni në rast të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, që nuk është korrigjuar sipas parashikimeve të nenit 12.3. Në këto raste, Koncesionari, do të ketë të drejtë të njoftojë zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni, me efekt 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit të këtij njoftimi.
- 13.2.2 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, për shkak të Mospërmbushjeve të Autoritetit Kontraktues, apo për shkak të një Veprimi Thelbësisht të Dëmshëm, Koncesionari ka të drejtë të kompensohet, sipas parashikimeve të Aneksit 4b.
- 13.2.3 Pas shlyerjes së kompensimit referuar më sipër, nga Autoriteti Kontraktues, atëherë Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralet, në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 22.
- 13.3 Zgjidhja për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore
- 13.3.1 Secila nga Palët mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni në rast të një Ngjarje të Forcës Madhore, e cila zgjat për më shumë se afati i caktuar në nenin 12.2.2, dhe pasojat e të cilës nuk mund të rregullohen nga asnjëra Palë.
- 13.3.2 Në rastet e Nenit 13.3.1 secila Palë do të njoftojë Palën tjetër mbi zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Koncesionit, me efekt të menjëhershëm.
- 13.3.3 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, Koncesionari ka të drejtë për kompensim, siç parashikohet nga Aneksi 4c, për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore.

13.3.4 Pas Datës së Zgjidhjes për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore, Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralet (për pjesën e realizuar, apo të mbetur, në vijim të një Ngjarje të Forcës Madhore), në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 22.

13.4 Zgjidhja e Kontratës me mirëkuptim

13.4.1 Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë Kontratë Koncesioni me mirëkuptim. Me zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni sipas kësaj pike, Koncesionari ka të drejtë të kompesohet, në mënyrën dhe masën e rënë dakord nga negociata të ndërsjella.

13.5 Të Drejtat e Palëve Financuese dhe Zëvendësimi i Koncesionarit

13.5.1 Njoftimi i Palëve Financuese

Autoriteti Kontraktues, në rast të zgjidhjes së kësaj kontrate sipas nenit 13.1 përveç njoftimit të Koncesionarit, njofton edhe Palët Financuese me qëllim dhënien e një mundësie për të ndihmuar Koncesionarin në korrigjimin e mospërmbushjes, ose në marrjen e masave për të rregulluar këto shkelje sikurse është rënë dakord, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

13.5.2 Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se pas ndihmës së ofruar nga Palët Financuese, nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga Koncesionari, atëherë Palët Financuese mund të zgjedhin të ndërhyjnë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues transferimin e projektit në duart e një ekipi manaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues, i cili duhet që të ketë ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit në momentin e këtij zëvendësimi.

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Financuese.

Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra siguroese mbi Hidrocentralet.

Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vazhdimësinë e projektit, Kontrata e Koncesionit do të zgjidhet.

Neni 14 Kontratat

14.1 Koncesionari ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, ka të drejtë të nënshkruajë kontrata për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni si dhe legjislacionit ne fuqi.

14.2 Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nën-kontraktuesin e propozuar:

- (a) Emrin e tij dhe adresën;
- (b) Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
- (c) Vlerën e nënkontratës
- (d) Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

14.3 Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.

14.4 Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 15 Sigurimi i Kontratës

15.1 Përpara hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, dhe si Kusht Paraprak i saj, Koncesionari duhet të ketë ngurtësuar për llogari të Autoritetit Kontraktues, pranë një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, të licensuar në Republikën Shqipërisë, vlerën e Sigurimit të Kontratës prej 62,136,836.2 (gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e tridhjetë gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë.2) Lekë, shumë e cila përfaqëson 10 % të vlerës totale të investimit. Forma e sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet kësaj Kontrate Koncesioni si Aneksi 5.

15.2 Koncesionari i ka të drejtë, dhe me kërkesë të tij, Autoriteti Kontraktues do të lejojë ç'ngurtësimin e 80% (tetëdhjetë %) të vlerës së Sigurimit të Kontratës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e nënshkrimit të certifikatës së pranimi të veprës nga Autoriteti Kontraktues, testimi dhe vënies në punë të saj sipas parashikimeve të nenit 11. Ndërkohë, pjesa e mbetur prej 20% (njëzet %) e vlerës së Sigurimit të Kontratës do të ç'ngurtësohet në përfundim të Periudhës së Koncesionit, në përputhje me nenin 4 të kësaj Kontrate Koncesioni.

Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit, kryerjen e testimit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera të kontratës.

Neni 16 Sigurimi




- 16.1 Koncesionari, në çdo kohë, do të pajiset, mbajë dhe ripërtëjë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e te Drejtave Koncesionare të nenit 5, dhe do t'i përcjellë, ose do te kujdeset qe t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e njësuara të çdo certifikatë sigurimi, pas marrjes se një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.
- 16.2 Koncesionari duhet të siguroje punimet e ndërtimit/montimit të Hidrocentraleve dhe më pas Projektin e plotë për gjithë kohëzgjatjen e Kontratës së Koncesionit, të paktën për rreziqet e parashikuara nga legjislacioni për sigurimet (aktualisht Ligji nr. 52/2014 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri-sigurimit", siç mund të ndryshohet, shtohet apo zëvendësohet herë pas here) gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë çdo vit pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
- 16.3 Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit apo në fazën e operimit të objektit, vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, restauruar dhe për të rikthyer Projektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma qe siguruesi do të paguajë për kompensimin e demit do te përballohet nga Koncesionari.
- 16.4 Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 16.5 Autoriteti Kontraktues do të jetë palë e bashkë-siguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 17 Tarifa Koncesionare

17.1 Tarifa koncesionare

- 17.1.1 Koncesionari do të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesionare të barabartë me vlerën e 2.1% (dy pikë një përqind) të prodhimit vjetor të energjisë elektrike, si dhe të çdo përfitimi tjetër që Koncesionari do të ketë, në përpjesëtim me përqindjen që përfaqëson tarifën koncesionare, nga prodhimi i kësaj energjie elektrike, duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtat që rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave të tjerë në atmosferë.
- 17.1.2 Palët nga nënshkrimi i kësaj Kontrate Koncesioni bien dakord se nëse Koncesionari dështon në arritjen e prodhimit vjetor të paraqitur gjatë Procedurës Përzgjedhëse, si pjesë e ofertës së Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë, tarifa e mësipërme e koncesionit do të jetë e pagueshme duke ju referuar prodhimit vjetor të paraqitur gjatë Procedurës Përzgjedhëse.

17.1.3 Mënyra e pagesës së tarifës së koncesionit do të përcaktohet sipas marrëveshje ndërmjet Palëve brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate koncesioni.



Neni 18 Kufizimet


- 18.1 Gjatë Periudhës së Koncesionit, Koncesionari do të kontrollohet nga anëtarët e Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë; me kusht, sidoqoftë, që (i) çdo anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë gëzon të drejtën të transferojë lirisht një pjesë apo të gjithë pjesëmarrjen e tij tek Koncesionari, në favor të anëtarëve të tjerë dhe/ose Palëve të Lidhura, në çdo moment; dhe (ii) çdo transferim i një pjese apo të gjithë pjesëmarrjes tek koncesionari apo palet e treta (përfshi një transferim të Kontrollit) do t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga Autoriteti Kontraktues, miratim i cili nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme; me kusht, gjithashtu, që në lidhje me çdo transferim të propozuar në përputhje me pikën (ii) më sipër (përfshi një transferim të Kontrollit), Autoriteti Kontraktues do të marrë në konsideratë eksperiencën, kapacitetin financiar (që do të përfshijë mbështetjen financiare nga palë të treta), qëndrueshmërinë dhe reputacionin e përfituesit të propozuar të transferimit.
- 18.2 Koncesionari nuk do të vendosë barrë, shesë, cedoje apo transferojë në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat dhe detyrimet e tij që lindin ose që rrjedhin nga kjo Kontrate Koncesioni pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues;
- 18.3 Për shmangien e çdo dyshimi, asnjë dispozitë e kësaj Kontrate Koncesioni nuk kufizon të drejtën e Koncesionarit për të vendosur lirisht kolateral sipas kërkesave të Palëve Financuese, për të rfinansuar Projektin, me kusht që të merret paraprakisht miratimi i Autoritetit Kontraktues.

Neni 19 Raportimi

- 19.1 Koncesionari është i detyruar që çdo 3 (tre) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve financiare dhe në natyrë, dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 20 Sanksionet

- 20.1 Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate Koncesioni, penalizon Koncesionarin si më poshtë:
- (a) Koncesionari për çdo ditë vonese në fillimin e punimeve, përtej afatit të parashikuar nga neni 10.1. penalizohet me 10,000 lekë.

- 
- (b) Për shkelje të afatit të perfundimit të ndërtimit të objektit, parashikuar sipas programit të punimeve bashkëlidhur si Aneksi 3, Koncesionari penalizohet me 10,000 lekë për çdo ditë vonese.
- (c) Për moskryerjen totale të investimeve, në vlerën e rënë dakord në nenin 9.1, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të parealizuara.

20.2 Mosarritja e kapacitetit të instaluar dhe mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike sipas kushteve të rëna dakord me këtë Kontratë Koncesioni, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- (i) Në rast se fuqia e instaluar është me e vogël se 90% e kapacitetit të instaluar të planifikuar sipas kësaj Kontrate Koncesioni, Koncesionari do të penalizohet deri në 10% të të ardhurave të pritshme që do të siguroheshin nga energjia elektrike e prodhuar nga kapaciteti i parealizuar (nën 90%).
- (ii) Në rast dështimi për fajin e tij, në arritjen e prodhimit vjetor të paraqitur gjatë Procedurës së Përzgjedhjes, si pjesë e ofertës së Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë (si mesatare e një periudhe 5-vjeçare), Koncesionari do të paguajë në vitin e fundit të çdo periudhe 5-vjeçare, një penaltet të barabarte me 4% të vlerës së prodhimit mesatar të parealizuar. Në rast se Koncesionari nuk e paguan kete penaltet, atehere kjo vlere do t'i mbahet ketij të fundit për llogari të Autoritetit Kontraktues, në sasi të energjise elektrike të prodhuar, nepermjet Entit Publik të Licencuar, nese Koncesionari eshte pjese e skemes mbeshtetese. Në te kundert Autoriteti Kontraktues, rezervon te drejten e heqjes se aksesit te transmetimit te energjise ne rrjetin publik, deri ne kryerjen e pageses.

Në çdo rast, me kryerjen e pageses së penaltetit, dështimi i mosarritjes të prodhimit vjetor nuk përbën kusht për zgjidhje të kontrates.

20.3 Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, siç parashikohet nga neni 8.1 i kësaj Kontrate Koncesioni, e penalizon Koncesionarin me 0.005% të vlerës së investimit për çdo dite vonese.

20.4 Sanksionet paguhen në llogarinë e Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhe 30 ditore lidhur me shkeljen.

20.5 Kur merret një vendim për zbatimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditëve nga data e dhënies së njoftimit. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë edhe kamatat ligjore së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor.

20.6 Zbatimi dhe pagesa e penalteteve sipas këtij neni nuk e çliron Koncesionarin nga përbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.

- 20.7 Këto penalitete, nëse nuk paguhen nga Koncesionari sipas afatit të parashikuar më sipër, do të mbahen nga Sigurimi i Kontratës, parashikuar nga neni 15 i kësaj Kontrate Koncesioni.


Neni 21 Korrigjimi i Shkeljeve

- 21.1 Nëse Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë Periudhës së Koncesionit, Koncesionari ka shkelur ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë Kontratë Koncesioni, ai do të informojë menjëherë Koncesionarin mbi këto shkelje dhe do të presë përgjigjen e Koncesionarit, me argumentet përkatëse, për një periudhë prej 40 ditësh, ose të ndonjë afati tjetër të arsyeshëm. Palët nëpërmjet një marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të korrigjohet shkelja.
- 21.2 Kjo procedurë nuk e çliron Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Neni 22 Transferimi i Aseteve/Dorëzimi

- 22.1 Me përfundimin e kësaj Kontrate Koncesioni, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin e asetëve dhe çdo titull mbi to tek Autoriteti Kontraktues. Asetet e dorëzuara tek Autoriteti Kontraktues në momentin e dorëzimit të jenë në kushte të mira pune dhe që mundësojnë operimin e tyre për një periudhë të caktuar nga përfundimi i afatit të kontratës.
- 22.2 Me përfundimin e afatit apo zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni:
- Me Dorëzimin e asetëve të Autoritetit Kontraktues, për Koncesionarin, do të përfundojnë automatikisht të drejtat e aksesit, e Drejta e Kalimit dhe Gëzimit të Qetë;
 - Koncesionari do t'i transferojë dhe do t'i kalojë Autoritetit Kontraktues atë pjesë të Punimeve të realizuara deri në atë moment, në rast përfundimi apo zgjidhjeje përpara përfundimit të Punimeve;
 - Koncesionari do t'i dorëzojë dhe do t'i kalojë Autoritetit Kontraktues çdo të drejtë pronësie apo interes mbi Hidrocentralet;
 - Koncesionari do të sigurohet për kalimin e të gjitha garancive në lidhje me Hidrocentralet në favor të Autoritetit Kontraktues.
- 22.3 Proçesi i Transferimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
- 22.4 Me përjashtim të Ngjarjeve të Forcës Madhore, Koncesionari do të dorëzojë asetet në kushte të mira, duke marrë parasysh normën përkatëse dhe amortizimin normal në momentin e dorëzimit.

- 22.5 Çdo e drejtë që Koncesionari ka fituar nëpërmjet kësaj Kontrate Koncesioni, do të përfundojë me transferimin e projektit.
- 22.6 Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga Koncesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të Autoritetit Kontraktues.
- 22.7 Me kryerjen e procedurave të mësipërme të dorëzimit, kur zgjidhja e kontrates behet jo per faj te koncesionarit, Autoriteti Kontraktues do të ç'ngurtësojë pa vonesa vlerën e mbetur te Sigurimit të Kontratës.



Neni 23

Përfundimi i Kontratës së Koncesionit

- 23.1 Kontrata e Koncesionit përfundon me mbarimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh dispozitat e parashikuara nga neni 4 i kësaj Kontrate Koncesioni.
- 23.2 Përfundimi i kësaj Kontrate Koncesioni me mbarimin e afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e çliron Koncesionarin nga detyrimi për të paguar detyrimet e prapambetura kundrejt Autoritetit Kontraktues dhe Palëve të Treta.

Neni 24

Konfidencialiteti

- 24.1 Secila nga Palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me Projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e Palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 25

Ndryshimet

- 25.1 Kjo Kontratë Koncesioni mund të ndryshohet, shtohet dhe/ose zëvendësohet vetëm me marrëveshje me shkrim të të dyja palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 25.2 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate Koncesioni apo Anekseve bashkëlidhur saj do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kontrate.

Neni 26

Bashkëpunimi Midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

- 26.1 Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari zotohen të bashkëpunojnë për të garantuar realizimin e plotë të projektit.

- 26.2 Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet Palëve, do të kryhet, vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë, apo në adresat e përditësuara nga Palët nëpërmjet një njoftimi. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjete) ditor nga data e ndryshimit.
- 26.3 Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues kërkesë me shkrim, për çdo ndihmë që do t'i kërkohet këtij të fundit, në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.
- 26.4 Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate Koncesioni janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr. 1001,
Tiranë - Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria "Idrolusa" Sh.p.k.
Adresa: Njesia Bashkiake nr 2, Rruga
Jeronim De Rada, Ndërtesa 1, Hyrja 25.
Apartamenti 40, Tiranë, Shqipëri,

Neni 27
Legjislacioni i Zbatueshëm

Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.


Neni 28
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 28.1 Çdo konflikt, mosmarrëveshje apo pretendim midis Palëve Kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 28.2 Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i perbashket, kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që lindin në lidhje me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata kompetente për zgjidhjen e konflikteve administrative.
- 28.3 Secila Palë, përveç mjeteve ligjore sipas kësaj Kontrate Koncesioni, do të ketë të drejtën të kërkojë për masa sigurimi pranë gjykatave të cilat kanë juridiksionin.

Neni 29
Regjistrimi i Kontratës së Koncesionit

- 29.1 Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit të zbatimit, Kontrata e Koncesionit duhet të regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

29.2 Kjo Kontratë Koncesioni u hartua në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.



PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES
Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Përfaqësuar nga:
Z.Agron Gaxho
Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së
Shërbimeve Mbështetëse

KONÇESIONARI
Shoqëria "Idrolusa" Sh.p.k.
Përfaqësuar nga:
Z. Sokol Muceku
Administrator



Petere

Skender H. Novolliu

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR. 2018 Rep.
NR. 918/1 Kol.



KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS "BOT" (NDËRTIM - OPERIM - TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E "HIDROCENTRALEVE TË LUSËS"

Në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, më datë 14 Shkurt 2017, viti 2017 (dy mije e shtatëmbëdhjetë), para meje noterit Dhurata Z. Sokol anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Rruga Sani Isakovi, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

MINISTRIA E ENERGISË DHE INDUSTRIË, që më poshtë do të quhet "AUTORITET KONTRAKTUES", përfaqësuar në bazë të autorizimit nr. 5185/5, datë 1.09.2017, të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetese Z. Agron Gaxho, shtetas shqiptar, i datëlindjes 12.5.1970, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta me numër ID H00512056E.

DHE


SUBJEKTI PËR QËLLIME TË VEÇANTA, SHOQËRIA "IDROLUSA" SHPK., që më poshtë do të quhet "KONCESIONARI", e themeluar nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik, shoqëritë "Idrol Energy" Sh.p.k., dhe "Scotta" S.p.a., në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit Shqiptar, regjistruar më datë 11/08/2017 në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me NUIS L72011006K, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga "Jeronim De Dada", Ndërtesa. 1, Hyrja. 25, Apartamenti. 40, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Z. Sokol MUCEKU, shtetas shqiptar, lindur në MAT më datë 18.10.1973, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit **027754300** (së bashku "Palët" dhe secila veçmas "Pala")

Hyrje

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Shqipërisë:

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistues me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;


- 
2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;
 3. Vlerëson formën e koncesionit “BOT”, si një formë koncesioni që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;
 4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
 5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;
 6. Ka nisur procedurat e tenderimit për dhënien e një koncesioni të formës “BOT” (Ndërtim – Operim - Transferim), për ndërtimin e “Hidrocentralet e Lusës”, në Bashkinë Klos, qarkun e Dibrës, shpallur nga Agjencia e Prokurimit Publik në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 24, datë 19/06/2017 (që më poshtë do të quhen “**PROCEDURA PËRZGJEDHËSE**”) dhe në përfundim të Procedurës Përzgjedhëse konkurruese, ka vlerësuar dhe përzgjedhur bashkimin e operatoreve ekonomik, shoqëritë “Idrol Energy” Sh.p.k. dhe “Scotta” S.p.a., që më poshtë do të quhen “**BASHKIMI I PËRKOSSHËM I OPERATORËVE EKONOMIK**”, si ofertuesi më i suksesshëm për koncesionin objekt të kësaj Kontrate.

Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve të sipërcituara, dhe në përfundim të Procedurës Përzgjedhëse, është vlerësuar si ofertuesi më i suksesshëm;
2. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve përkatëse në pellgun ujëmbledhës të Lusës, nga burimet e tij deri në kутen 500 m m.n.d, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj Kontrate Koncesioni;
4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare;
5. Ka themeluar subjektin për qëllime të veçanta, për zbatimin e objektit të kësaj Kontrate Koncesioni.

Atëherë, Palët lidhin këtë Kontratë Koncesioni (përcaktuar si vijon) bazuar në Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, duke rënë dakord për sa më poshtë:

Përmbajtja



KREU I.....

Neni 1.....

Perkufizime, interpretime.....

Neni 2.....

Objekti i Koncesionit.....

Neni 3.....

Karakteristikat e Hidrocentralit.....

Neni 4.....

Periudha e Koncesionit.....

KREU II.....

Neni 5.....

Të Drejtat Koncesionare - Sheshi.....

Neni 6.....

Monitorimi dhe Mbikëqyrja.....

Neni 7.....

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues.....

KREU III.....

Neni 8.....

Detyrimet e Koncesionarit.....

Neni 9.....

Investimi.....

Neni 10.....

Programi Punimeve.....

Neni 11.....

Komisionimi dhe Vënia në Punë e Veprës.....

Neni 12.....

Mospërmbushjet, Forca Madhore dhe Veprimet Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme.....

Neni 13.....

Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit.....

Neni 14.....



Kontratat	
Neni 15.....	
Sigurimi i Kontratës	
Neni 16.....	
Sigurimi	
Neni 17.....	
Tarifa Koncesionare.....	
Neni 18.....	
Kufizimet.....	
Neni 19.....	
Raportimi.....	
Neni 20.....	
Sanksionet	
Neni 21.....	
Korrigjimi i Shkeljeve	
Neni 22.....	
Transferimi i Aseteve/Dorëzimi	
Neni 23.....	
Përfundimi i Kontratës së Koncesionit.....	
Neni 24.....	
Konfidencialiteti	
Neni 25.....	
Ndryshimet	
Neni 26.....	
Bashkëpunimi Midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.....	
Neni 27.....	
Regjistrimi i Kontratës së Koncesionit.....	
Neni 28.....	
Legjislacioni i Zbatueshëm	
Neni 29.....	
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....	

Aneksi 1

HARTAT E SHESHIT

Aneksi 2

VLERA E INVESTIMIT SIPAS PREVENTIVIT TË PUNIMEVE

Aneksi 3

PROGRAMI I PUNIMEVE DHE AFATET

Aneksi 4

KOMPENSIMI NË RAST ZGJIDHJE

Aneksi 5

SIGURIMI I KONTRATËS



KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME



Neni 1
Përkufizimet, Interpretimi


1.1 Përkufizimet

Kudo që në këtë Kontratë Koncesioni përdoren termat e mëposhtme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon. Termat e tjerë që mund të përkufizohen diku tjetër në këtë Kontratë Koncesioni do të kenë kuptimet që parashikohen në nenet apo ankesat përkatëse të kësaj Kontrate Koncesioni.


- 1.1.1 **Aneks:** është çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga Palët dhe që Palët ja bashkëlidhin kësaj Kontrate Koncesioni, si pjesë përbërëse e saj.
- 1.1.2 **Autoriteti Kontraktues:** është ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë elektrike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë.
- 1.1.3 **Autoritet Publik:** do të thotë (i) Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri ose nënndarje politike e saj; dhe (ii) çdo gjykatë ose çdo entitet tjetër qeveritar, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose (iii) çdo njësi e pushteti vendor, të cilat ushtrojnë juridiksion sipas Ligjit mbi Koncesionarin, ose (iv) çdo autoritet i pavarur rregullator në Republikën e Shqipërisë.
- 1.1.4 **Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik:** do të thotë bashkërisht shoqëritë: (i) "Idrol Energy" Sh.p.k., dhe (ii) "Scotta" S.p.a., të cilët kanë krijuar shoqërinë SPV, "Idrolusa" Sh.p.k., sipas kërkesave të Ligjit për Koncesionet, i ndryshuar dhe me kërkesë të Autoritetit Kontraktues.
- 1.1.5 **Certifikata e Pranimit të Veprës:** do të thotë dokumenti i lëshuar nga Autoriteti Kontraktues për secilin Hidrocentral, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 11.
- 1.1.6 **Data e Hyrjes në Fuqi:** është data në të cilën kjo Kontratë Koncesioni hyn në fuqi, siç përcaktohet në Nenin 4.1 më poshtë.
- 1.1.7 **Data e Mbarimit:** është data e përvjetorit të 35-të të Datës së Hyrjes në Fuqi.
- 1.1.8 **Data e Shtyrë e Mbarimit:** është data që përkon me përfundimin e Periudhës së Pezullimit, në rastet e përcaktuara nga Neni 4.1.2.
- 1.1.9 **Data e Zgjidhjes:** do të thotë data e zgjidhjes paraprake të kësaj Kontrate Koncesioni, në përputhje me kushtet e përcaktuara sipas Nenit 13.



- 1.1.10 **Ditë Pune:** është çdo ditë e javës përveç ditës së Shtunë, të Diele dhe ditëve të tjera të festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.
- 1.1.11 **Enti Rregullator i Energjisë (ERE):** është institucioni i pavarur rregullator i sektorit të energjisë elektrike, që vepron sipas legjislacionit Shqiptar të sektorit të energjisë elektrike.
- 1.1.12 **E Drejta për Kalim:** do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjese të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.13 **Furnizuesi i Shërbimit Universal:** është shoqëria e licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit ekzistues shqiptar për sektorin e energjisë elektrike.
- 1.1.14 **Gëzim i Qetë:** do të thotë e drejta ekskluzive për të përdorur dhe gëzuar Sheshin (duke përfshirë objektet ekzistuese, nëse ka të tilla) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Periudhës së Koncesionit (përcaktuar sipas nenit 4), në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni, pa ndërhyrje të pajustificuara nga Autoriteti Kontraktues, nga ndonjë Autoritet Publik ose nga ndonjë subjekt privat, përveçse në rastet kur përcaktohet ndryshe në këtë Kontratë Koncesioni.
- 1.1.15 **Hidrocentrali/et:** janë bashkërisht të gjitha centralet vijuese të kaskadës së perroit Lusë, nga burimet e tij deri në kuoten 500 mnd, në Bashkinë Klos, qarku Dibër, dhe veçmas secili prej (i) HEC Lusa 1, (ii) HEC Lusa 2, së bashku me tërësinë e aseteve, punimeve dhe makinerive apo pajisjeve të instaluara për prodhimin e energjisë elektrike dhe shfrytëzimin e optimizuar të kaskadës.
- 1.1.16 **Investimi:** është vlera totale monetare sipas preventivit të punimeve paraqitur në ofertën e Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik gjatë Procedurës Përzgjedhëse (një kopje e preventivit të punimeve bashkëlidhet si Aneksi 2), që do të investohet tek Koncesionari, në formën e kapitalit apo të huave, dhe që do të shërbejë për financimin e projektimit, ndërtimin dhe pajisjen e Hidrocentraleve me makineritë e nevojshme, duke përjashtuar këtu për shmangien e dyshimeve, çdo kosto financimi apo kosto të tjera, dhe siç mund të përditësohet në çdo kohë, deri në marrjen nga Koncesionari të lejeve dhe licencave të nevojshme.
- 1.1.17 **Instrument Financiar:** do të thotë çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguruese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e Objektivit të Koncesionit, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
- 1.1.18 **Komisionimi:** është procedura e parashikuar sipas nenit 11 të kësaj Kontrate Koncesioni për marrjen e Certifikatës së Pranimit të Veprës, për secilin nga Hidrocentralet.

- 
- 1.1.19 **Koncesionari:** do të thotë subjekti për qëllime të veçanta, shoqëria "HidroLusa" Sh.p.k., themeluar nga bashkimi i operatoreve ekonomik i zgjedhur si kontraktuesi me i suksesshem, siç identifikohet më sipër në këtë Kontratë Koncesioni.
- 1.1.20 **Kontroll:** do të thotë e drejta për të zgjedhur shumicën e organeve të administrimit (ose të ndonjë organi tjetër të ngjashëm të krijuar) ose ndryshe për të drejtuar menaxhimin dhe politikat e një personi juridik, drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë, qoftë nëpërmjet pronësisë, të drejtave të votës, me anë marrëveshjesh ose në forma të tjera.
- 1.1.21 **Kontratat:** janë të gjitha kontratat e nënshkuara nga Koncesionari, me kontraktor për realizimin e Punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt shfrytëzimin, operimin e Hidrocentraleve dhe/ose sigurimin e financimit.
- 1.1.22 **Kontrata e Koncesionit ose Kontrata:** është kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që përcaktohet si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj.
- 1.1.23 **Lejet:** do të thotë çdo leje, autorizim, licencë apo miratim, që lëshohet apo ripërtërihet nën përgjegjësinë e Autoriteteve Publike, dhe që është e nevojshme sipas Ligjit për zbatimin e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.24 **Ligj:** do të thotë çdo ligj i zbatueshëm kombëtar ose vendor në Republikën e Shqipërisë, siç është në fuqi në çdo kohë, përfshi këtu çdo urdhëresë, dekret ose rregullore, akt nënligjor ose çdo rregull, kod ose udhëzim, miratuar nga ndonjë Autoritet Publik me juridiksion, në masën që aktet si më sipër rezultojnë të botuara rregullisht dhe të disponueshme publikisht.
- 1.1.25 **Ligji Për Koncesionet:** do të thotë legjislacioni shqiptar mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat, aktualisht Ligji nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" i ndryshuar, siç mund të ndryshohet, shtohet apo zëvendësohet herë pas here.
- 1.1.26 **Mospërmbushjet e Autoritetit Kontraktues:** janë shkeljet nga Autoriteti Kontraktues, te detyrimeve thelbësore ose garancive sipas kësaj Kontrate Koncesioni, që pengojnë thelbësisht, vonojnë apo bëjnë të pamundur zbatimin e Objektivit të Koncesionit nga ana e Koncesionarit.
- 1.1.27 **Mospërmbushjet e Koncesionarit:** janë secila prej ngjarjeve vijuese: - (i) shkelja nga Koncesionari e detyrimeve thelbësore të kësaj Kontrate Koncesioni, që shkakton një efekt thelbësisht negativ në zbatimin e Objektivit të Koncesionit (ii) disponimi i Hidrocentraleve, apo pjesëve të tyre, nga ana e Koncesionarit në kundërshtim me kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni, apo kur ndodh një Ndryshim Kontrolli, pa u marrë miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktues sipas kërkesave të kësaj Kontrate Koncesioni, (iii) braktisja e Punimeve nga ana e Koncesionarit, pa asnjë arsye të justifikuar, për më shumë se 100 (njëqind) ditë të njëpasnjëshme(iv) si dhe çdo shkelje tjetër e kushteve të kësaj kontrate koncesionare dhe legjislacionit në fuqi.

- 1.1.28 **Ndryshim i Kontrollit:** do të thotë transferimi i Kontrollit, nga një palë tek një palë tjetër, e cila nuk është e Palë e Lidhur me palën që transferon kontrollin.
- 1.1.29 **Ngjarje e Forcës Madhore:** do të thotë çdo ngjarje që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate Koncesioni, rrethane e cila është jashtë kontrollit të arsyeshëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Palës së cënuar, që rezulton në ose shkakton një dështim total apo të pjesshëm të Palës së cënuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate Koncesioni (me përjashtim të pagesës së parave), ngjarje të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:(i) akte lufte ose luftë civile (të deklaruara ose jo), konflikte të armatosura ose akte terrorizmi, akte rebelimi, kryengritje, trazira civile, çdo akt sabotimi, bllokadë ose embargo ose (ii) ndotje nukleare, kimike ose biologjike, tërmet, kryengritje dhe trazira civile, (iii) zjarr, shpërthim, rrufe, stuhi, shtrëngatë, përmbytje, rrëshqitje toke, plasje apo derdhje e rezervuarë uji, aparaturash apo tubacionesh, valët e trysnisë të shkaktuara nga mjete që udhëtojnë me shpejtësinë e zërit, rrezatimet jonike, epidemi apo murtajë, (iv) greva politike si dhe greva shtetërore ose jo shtetërore.
- 1.1.30 **Ngjarjet e Zgjidhjes:** do të thotë çdo Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm, i cili mbetet i pakorrigjuar sipas Nenit 12.3, si dhe çdo ngjarje tjetër, e cila, sipas kësaj Kontrate Koncesioni i jep të drejtë një Palë për të zgjidhur këtë Kontratë Koncesioni në përputhje me Nenin 13.
- 1.1.31 **Nisja e punimeve:** është data e nisjes së zbatimit të Punimeve të ndërtimit, sipas Nenit 10.1 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.32 **Objekti i Koncesionit:** do të thotë financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, shfrytëzimi, mirëmbajtja e Hidrocentraleve dhe transferimi i tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni.
- 1.1.33 **Operimi:** do të thotë tërësia e veprimeve të Koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.34 **Palë Financuese:** do të thotë çdo institucion financiar i licencuar si i tillë, pa përjashtuar entitet private, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e Objektivit të Koncesionit.
- 1.1.35 **Palë e Tretë:** është çdo palë e ndryshme nga Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari.
- 1.1.36 **Palë të Lidhura:** janë dy persona mes të cilëve ekziston, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, një marrëdhënie Kontrolli, dhe/ose dy a më shumë persona juridik, të cilët kontrollohen, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nga i njëjti person juridik/individ.

- 
- 1.1.37 **Periudha e Koncesionit:** do të thotë afati i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.38 **Periudhe Pezullimi:** do të thotë periudha e pezullimit automatik të Periudhës së Koncesionit, në rastet e parashikuara sipas Nenit 4.1.2.
- 1.1.39 **Praktika e Mirë e Industrisë:** do të thotë, në çdo kohë, ushtrimi në masën e duhur të aftësisë, kujdesit dhe parashikimit që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme në atë kohë, nga një person i aftë dhe me përvojë që kërkon, në mirëbesim, të përmbushë detyrimet e tij kontraktore, duke vepruar në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi, dhe që angazhohet në të njëjtin lloj aktiviteti, dhe në rrethana dhe kushte të njëjta ose të ngjashme.
- 1.1.40 **Procedura Përzgjedhëse:** do të thotë procedura për dhënien me koncesion të Ndërtimit e Hidrocentralit të Lusës”, siç identifikohet në hyrjen e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.41 **Punimet:** janë tërësia e veprimeve për projektimin, ndërtimin, komisionimin dhe vënien në punë të Hidrocentraleve, në përputhje me projektin e zbatimit.
- 1.1.42 **Regjistri i Pasurive të Paluajtshme:** do të thotë zyra(t) vendore të/e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) që ka juridiksionin territorial në zonën e Sheshit të identifikuar sipas nenit 5.
- 1.1.43 **Sheshi:** do të thotë sipërfaqet ku do të ndërtohen objektet e Hidrocentraleve, përfshi këtu sipërfaqet e nevojshme për Punimet e përkohshme (pjesë të projektit) si dhe sipërfaqe të tjera që janë të nevojshme për zbatimin e projektit, siç identifikohen në hartat e bashkëlidhura si Aneksi 1.
- 1.1.44 **Sigurimi i Kontratës:** është vlera monetare e instrumentit financiar të sigurisë, lëshuar nga një bankë apo nga një shoqëri sigurimesh e licensuar në Republikën e Shqipërisë, që siguron interesat e Autoritetit Kontraktues, sipas nenit 15, në rastet e shkeljes së kushteve të kësaj Kontrate Koncesioni nga ana e Koncesionarit.
- 1.1.45 **Skema Mbështetëse e Trajtimit të Energjisë së Prodhuar:** do të thotë skema e mbështetjes financiare që zbatohet aktualisht në lidhje me energjinë elektrike të prodhuar nga “burime të rinovueshme”
- 1.1.46 **Tarifa Koncesionare:** është kompensimi monetar që Koncesionari paguan në formën e lëvrimit të energjisë elektrike pa pagesë, në sasi të dhe mënyrat e përcaktuara sipas nenit 17 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.47 **Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm:** do të thotë secila nga ngjarjet e mëposhtme (i) shpronësimi, konfiskimi apo sekuestrimi, ose masa të tjera me efekt të njëjtë, i Hidrocentraleve, apo pjesëve të tyre, ose i të Drejtave Koncesionare apo të vetë Koncesionarit, nga ana e Autoritetit Kontraktues ose nga ana e ndonjë autoriteti tjetër publik (jo privat), (ii) dështimi ose vonesë nga

Autoritetet Publike në dhënien e Lejeve të kërkuara nga Ligji ndërkohë që koncesionari ka aplikuar për pajisjen me këto leje në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ose (iii) dështimi apo vonesa e operatorëve të rrjetit për të lidhur Hidrocentralet në rrjetin kombëtar të energjisë, sipas kërkesave të Ligjit, në kushtet e parashikuara nga kjo Kontratë Koncesioni.

1.2 Interpretimi

1.2.1 Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë Koncesioni:

- (a) Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- (b) Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjënjë;
- (c) Çdo frazë që fillon me fjalët “*duke përfshirë*”, “*përfshin*”, “*në veçanti*”, “*për shembull*” e të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
- (d) Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën paragrafët, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi në interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni;
- (e) Referimet në dispozitat dhe Anekset janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate Koncesioni;

1.2.2 Kur afati është caktuar me “*ditë*”, afati do të llogaritet në ditë kalendarike, përveçse kur përcaktohet shprehimisht në Ditë Pune. Një afat prej një ose më shumë ditësh kalendarike ose Ditësh Pune do të nisë të llogaritet duke u nisur nga dita kalendarike ose Dita e Punës në të cilën ndodh ngjarja.

1.2.3 Kur afati është caktuar me “*javë*”, “*muaj*” ose “*vite*”, atëherë afati do të llogaritet nga data në datë (“*data korresponduese*”); kur afati është caktuar në “*muaj*”, nëse muaji i fundit kalendari i periudhës përkatëse nuk ka një datë korresponduese, të ditës së muajit kalendari kur fillon afati, atëherë afati do të përfundojë në ditën e fundit kalendarike të muajit të fundit kalendari të periudhës.

1.2.4 Në rast mospërputhje midis çdo termi të përcaktuar sipas nenit 1.1 dhe një ndonjë përkufizimi tjetër në ndonjë parashikim tjetër të kësaj Kontrate Koncesioni, Aneksi apo shtojcë të ndonjë aneksi të kësaj Kontrate Koncesioni, atëherë, kuptimi i dhënë në nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo parashikim tjetër të kësaj Kontrate Koncesioni, Aneksi apo shtojcë të ndonjë aneksi të kësaj Kontrate Koncesioni.

Neni 2 Objekti i Koncesionit

2.1 Në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Koncesioni, Autoriteti Kontraktues, në bazë të Ligjit të Koncesioneve, i jep Koncesionarit të drejtat koncesionare sipas nenit 5, për zbatimin e Objektivit të Koncesionit, të formës BOT (që do të thotë ndërtimin, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së Koncesionit), si vijon:

- *financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen e Hidrocentraleve dhe transferimin e tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni.*

Neni 3 Karakteristikat e Hidrocentralit

3.1 Kaskada e hidrocentraleve mbi përroin e Lusës përbëhet nga: (i) HEC Lusa 1, dhe (ii) HEC Lusa 2, të cilët do të shfrytëzojnë potencialin hidroenergjetik të pellgut ujëmbledhës të lumit të Lusës, nga burimet e tij deri në kuotën 500 m m.n.d, në Bashkinë Klos, Qarku Dibër dhe do të kenë karakteristikat teknike vijuese:

Hidrocentrali “Lusa 1”

- Kuotat e veprave
- Kuota e veprës së marrjes 1750 m m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit 1103 m m.n.d.
- Fuqia e instaluar (kW) $N = 1\,580$ kW.
- Energjia mesatare vjetore kWh $E = 5\,754\,289$ kWh/vit.

Hidrocentrali “Lusa 2”

- Kuotat e veprave
- Kuota e veprës së marrjes 1100 m m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit 500 m m.n.d.
- Fuqia e instaluar (kW) $N = 4\,800$ kW.
- Energjia mesatare vjetore kWh $E = 16\,879\,977$ kWh/vit.

Parametrat hidroenergjetikë totalë do të jenë:

- **Fuqia e instaluar:** $N = 6\,380$ kW
- **Energjia mesatare vjetore:** $E = 22\,634\,266$ kWh

3.2 Karakteristikat teknike mund të pësojnë ndryshime të mundshme, në marrëveshje ndërmjet Palëve në variantin përfundimtar të projekt-zbatimit të Hidrocentraleve.

Neni 4 Periudha e Koncesionit



4.1 Hyrja në fuqi

4.1.1 Kjo Kontratë Koncesioni dhe të drejtat e detyrimeve të Paleve do të hynë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët ("**Data e Hyrjes në Fuqi**") dhe do të mbetet në vijim në fuqi dhe me efekte të plota deri në Datën e Mbarimit (d.m.th. përvjetori i 35-të i Datës së Hyrjes në Fuqi), apo në Datën e Shtyrë të Mbarimit, në rastet e parashikuara sipas nenit 4.1.2 këtu më poshtë, përveçse kur kjo Kontratë Koncesioni zgjidhet sipas parashikimeve të nenit 13, dhe në këtë rast afati përfundon në Datën e Zgjidhjes.

4.1.2 Palët bien dakord se, në rast të një Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues, të një Ngjarje të Forcës Madhore ose të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, të njoftuar nga Koncesionari në përputhje me nenin 12.2 dhe/ose 12.3, do të shkaktojë pezullimin automatik të llogaritjes së Periudhës së Koncesionit për një afat që i korrespondon periudhës së ngjarjes së Forcës Madhore ose të Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm gjatë të cilës Koncesionari është i pamundur apo vonohet, në përmbushjen e kësaj Kontrate Koncesioni (përfshi këtu kohën e arsyeshme dhe të nevojshme për të riparuar dëmet ne marreveshje mes paleve) për shkak të ndodhjes së kësaj Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues, Ngjarje të Forcës Madhore ose Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm ("**Periudha e Pezullimit**"); Njoftimi me shkrim i pezullimit dërguar nga Koncesionari, duhet të përmbajë një përshkrim të rrethanave dhe një parashikim të kohëzgjatjes së Periudhës së Pezullimit, nëse një parashikim i tillë është i mundur. Periudha e Koncesionit do të rinisë me njoftimin me shkrim të Autoritetit Kontraktues drejtuar koncesionarit pasi Ngjarja e Forcës Madhore ose Veprimi Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm nuk shkakton më pamundësi apo vonesa për Koncesionarin, dhe/ose kur Koncesionari të ketë riparuar dëmet ne marreveshje mes paleve, me kusht që Koncesionari, gjatë Periudhës së Pezullimit, do të jetë i detyruar të marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të reduktuar efektet e pezullimit mbi aftësitë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Kontrate Koncesioni, dhe për të mundësuar rifillimin e llogaritjes së Periudhës së Koncesionit, sa më shpejt të jetë e mundur, me përjashtim të rastit kur kjo Ngjarje e Forcës Madhore ose Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm shkakton një Ngjarje Zgjidhje.

4.2 Zgjatja e Periudhës së Koncesionit pas Datës së Mbarimit apo Datës së Shtyrë të Mbarimit

4.2.1 Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit mund të zgjatet nëse është e nevojshme, duke u bazuar në një marrëveshje tjetër, në përputhje me parashikimet e Ligjit të Koncesioneve, në përputhje me kohën e përshtatshme për të konsideruar projektin fitimprurës dhe financiarisht të përshtatshëm, në përputhje me analizën financiare të "vlerës për para", "IRR" ose çdo analizë tjetër të përshtatshme për këtë vlerësim.

KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5
Të Drejtat Konçesionare – Sheshi



5.1 Dhënia e të Drejtave Koncesionare


5.1.1 Duke nisur nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit për të gjithë Periudhën e Koncesionit, i cili pranon, të drejtën:

- (a) të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të operojë, shfrytëzojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralet, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë Koncesioni;
- (b) të përdorë burimet ujore të Lumit Lusë për realizimin e Objektivit të Koncesionit, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni, dhe duke respektuar kushtet mjedisore dhe rrjedhën ekologjike sipas Lejeve;
- (c) të përdorë, pa pagesë, tokën dhe asetet publike në Shesh, përfshi zhavorrin dhe materialet e tjera të nevojshme, pa kërkuar Leje të tjera shtesë, për qëllime të zbatimit të Objektivit të Koncesionit.
- (d) të marrë Sheshin, për të patur të Drejtën e Kalimit dhe Gëzimin e Qetë, siç parashikohen nga Neni 5.2;
- (e) të aplikojë, me diskrecionin e tij të vetëm, për çdo skemë mbështetje të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, në përputhje me Ligjin Nr. 7/2017, datë 2.2.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, siç mund të ndryshohet, shtohet apo zëvendësohet herë pas here.
- (f) me mbarimin e Periudhës së Koncesionit t’i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t’i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentraleve dhe të objekteve ekzistuese (nëse ka) të cilat të jenë në gjëndje të mire pune, si dhe, në çdo rast, të kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjidhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së bashku me të **“Drejtat Koncesionare”**);
- (g) Koncesionari do të ketë të drejtën ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet (perftohet) nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në certifikatat Certified Emission Reductions (CER).

5.2 Dhënia e Sheshit

5.2.1 Pa vonesa pas Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, Autoriteti Kontraktues do t’i japë Koncesionarit të drejtën e Sheshit, të Drejtën e Kalimit dhe do t’i garantojë Gëzimin e Qetë, me të vetmin kusht që Koncesionari t’i ketë paraqitur Autoriteti Kontraktues, kopje autentike të certifikatave të sigurimit, të

cilat vërtetojnë (në masën e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues), se Konçesionari është i pajisur me të gjitha pajisjet e sigurimit dhe garancitë e kërkuara për këtë qëllim, në përputhje me nenin 10 të kësaj Kontrate Koncesioni.




- 5.2.2 Në këtë kuadër, dhe pa cenuar detyrimet e tij kontraktore Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit në marrëdhëniet me Palë të Treta, në mënyrë që të shmanget çdo pengesë, që mund të haset në kuadër të shpronësimeve apo çdo lloji tjetër pengese, në lidhje me titujt përkatës të përdorimit të tokës/aseteve publike, për t'i siguruar Koncesionarit të Drejtën e Kalimit dhe Gëzimin e Qetë të Sheshit, për realizimin e punimeve dhe operimin normal të Hidrocentraleve. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm, kur moszgjidhja e pengesave të mësipërme, vjen si rezultat i mos përmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse, për shkak të veprimeve të fajshme të Koncesionarit.
- 5.2.3 Palët bien dakord që nëse i gjithë Sheshi apo pjesë e tij, është pronë private, dhe Koncesionari, pavarësisht përprjekjeve të arsyeshme, nuk ka arritur të merret vesh me pronarët private, në terma të arsyeshëm, për fitimin e të drejtave të përshtatshme të përdorimit me qëllim zbatimin e Objektivit të Koncesionit, atëherë Koncesionari ka të drejtë të kërkojë shpronësimin për interes publik sipas ligjit, të pasurive private që mund të përfshihen në Shesh, me kusht që Koncesionari të përballojë të gjitha kompensimet, kostot dhe shpenzimet e lidhura me shpronësimet, në përputhje me ligjin.
- 5.2.4 Palët bien gjithashtu dakord që nëse i gjithë apo pjesë e tokës apo asetëve publike të Sheshit, nuk janë në pronësi/administrim të Autoritetit Kontraktues, atëherë Autoriteti Kontraktues do të asistojë Koncesionarin në marrjen, nga autoriteti publik përkatës që ka në pronësi/administrim tokën/asetin, e një titulli të vlefshëm përdorimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.
- 5.2.5 Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës së Kalimit, garantimin e Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujën e lumit të Lusës, Koncesionari e pranon Sheshin "siç është" që nga data e një dhënieje të tillë. Pa cenuar parashikimet e mësipërme, Autoriteti Kontraktues do të mbrojë Koncesionarin nga çdo pretendim i ndonjë Pale të Tretë ndaj Koncesionarit, në lidhje me pronat publike që përbëjnë Sheshin.

5.3 Skema Mbështetëse Për Trajtimin e Energjisë së Prodhuar

- 5.3.1 Koncesionari, nëse dëshiron, mund të zgjedh të përfitojë nga skema e mbështetjes, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe procedurave të miratuara nga ERE.
- 5.3.2 Autoriteti Kontraktues, garanton Koncesionarin se me kryerjen e procedurave të komisionimit dhe vënies në punë të veprës të parashikuar nga neni 11, qofte, edhe të njërit prej Hidrocentraleve, brenda datës 31 dhjetor 2020, apo brenda datës së mëvonshme, që mund të parashikohet nëpërmjet ndonjë shtyrje të afatit të cilësuar

ne nenin 22(1) të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, do të zbatohet blerja e energjisë, ndaj të gjitha Hidrocentraleve, te vene ne pune brenda këtyre afateve, për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh.



5.4 Hidrocentralet në rrjedhën e sipërme

- 5.4.1 Palët gjithashtu shprehimisht bien dakord se, dhe Autoriteti Kontraktues garanton Koncesionarin se, në atë masë që, Autoriteti Kontraktues, apo ndonjë Autoritet Publik tjetër, ka dhënë ose do të japë ndonjë të drejtë një Pale të Tretë për të kontrolluar, shfrytëzuar, devijuar ose shkarkuar rezervat ujore në pjesën e sipërme të Sheshit (“**Hidrocentralet në Rrjedhën e Sipërme**”), (i) ndërtimi dhe operimi i këtyre Hidrocentraleve në Rrjedhën e Sipërme nuk do të zvogëlojë prurjet ditore që do të kishin ardhur në Hidrocentrale, sipas rrjedhës natyrale; (ii) regjimi operacional i këtyre Hidrocentraleve në Rrjedhën e Sipërme nuk do të ndikojë negativisht në operacionet e Hidrocentraleve.
- 5.4.2 Autoriteti Kontraktues do të mbrojë dhe do të mbajë Koncesionarin të pacënuar nga çdo dhe të gjitha humbjet e shkaktuara si me siper dhe merr masa per rregullimin e shkëljeve brenda 90 ditëve. Në rast të kundërt Koncesionari gëzon të drejtën të ushtrojë zgjidhje në përputhje me nenin 13.2 të kësaj Kontrate Koncesioni.

5.5 E drejta e shitjes

- 5.5.1 Koncesionari do të ketë të drejtë, me diskrecionin e tij të vetëm, nese heq dore nga skema mbeshtetese sipas ligjit nr.7/2017, date 02.02.2017 “Per nxitjen e përdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme”, të shesë një pjesë apo të gjithë energjinë e prodhuar prej Hidrocentraleve, duke përfshirë këtu të drejtën për të përfituar certifikata të gjelbra, apo ndonjë incentivë tjetër mjedisore, në lidhje me prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, duke marrë në konsideratë gjithashtu parashikimet e nenit 17.

Neni 6 Mbikëqyrja dhe Monitorimi

6.1 Mbikëqyrja e Përgjithshme dhe Monitorimi

- 6.1.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë Periudhës së Koncesionit, nëpërmjet personave të autorizuar, e me shpenzimet e veta, të mbikëqyrë zbatimin e punimeve të ndërtimit, të monitorojë progresin e zbatimit të Objektivit të Koncesionit dhe të verifikojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë Koncesioni, në të gjitha fazat e zbatimit të saj.
- 6.1.2 Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë mbikëqyrje të përgjithshme dhe monitorim në çdo kohë, në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin nga ana e Koncesionarit, të

detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate Koncesioni. Rezultatet e monitorimit do t'i bëhen të njohura Koncesionarit, me shkrim.




- 6.1.3 Në rast se gjatë veprimtarisë së mbikëqyrjes së përgjithshme dhe monitorimit, Autoriteti Kontraktues vëren shkelje të Kontratës së Koncesionit nga ana e Koncesionarit, atëherë Koncesionari do të njoftohet me shkrim, dhe Autoriteti Kontraktues do të propozojë masa korrigjuese dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7 **Detyrimet e Autoritetit Kontraktues**

Përtej detyrimeve të marra përsipër diku tjetër në këtë Kontratë Koncesioni, Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- 7.1 Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj Kontrate Koncesioni, pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.
- 7.2 Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj veprë. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licencë, autorizim, vjen si rezultat i mospërmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.
- 7.3 Të miratojë projektin e zbatimit të Hidrocentraleve, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me ofertën e paraqitur gjatë Procedurës Përzgjedhëse nga Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik (ose të ndryshuar me marrëveshje mes Palëve).
- 7.4 Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike/operatorë të sektorit elektroenergjetik, për qëllime të realizimit të Objektivit të Koncesionit.
- 7.5 T'i garantojë Koncesionarit të Drejtat Koncesionare të parashikuara në nenin 5, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Koncesionit.
- 7.6 Të garantojë Koncesionarin së ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë negativisht në interesat e Koncesionarit, bazuar në këtë Kontratë Koncesioni.
- 7.7 Të mbeshtese koncesionarin për lidhjen e Hidrocentraleve me rrjetin kombëtar të transmetimit të energjisë, në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 7.8 Të garantojë Koncesionarin për blerjen e të gjithë prodhimit të energjisë elektrike të Hidrocentraleve nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Kontrate Koncesionit dhe legjislacionit në fuqi.

- 
- 7.9 Të garantojë Koncesionarin për përmbushjen, pa vonesa, të çdo detyrime të lidhur me kompensimin e Koncesionarit, në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 7.10 Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, merr përsipër procedurën e shpronësimit për tokën prone private (nëse ka), e cila do të shfrytëzohet për ndërtimin e Hidrocentraleve, me kusht që Koncesionari të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore për këtë shpronësim, si dhe të paguajë shpenzimet e shpronësimit.
- 7.11 Autoriteti Kontraktues merr përsipër të mbështesë Koncesionarin për lidhjen e centralit me Rrjetin Elektrik Kombëtar në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të gjithë kapacitetin e instaluar të përcaktuar në këtë kontrate.

KREU III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONÇESIONARIT

Neni 8 Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe Objektin e Koncesionit, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Koncesioni.

Në veçanti, Koncesionari duhet:

- 8.1 Të ketë paraqitur, brenda 6 (gjashtë) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, për miratim pranë Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit për të gjithë Hidrocentralet.
- 8.2 Të pajiset në përputhje me Ligjin, me të gjitha Lejet e nevojshme për realizimin e kësaj Kontrate Koncesioni;
- 8.3 Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 3 bashkëlidhur kësaj Kontrate Koncesioni, siç mund të përditësohet kohë pas kohe;
- 8.4 Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara ne Aneksin 3 dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë Koncesioni;
- 8.5 Të zbatojë projektin për ndërtimin e Hidrocentraleve, me fuqi totale të instaluar prej jo më pak se 6,380 (gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë) kW;
- 8.6 Të administrojë projektin për Periudhën e Koncesionit;
- 8.7 Të marrë masat e nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe rehabilitimin e çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga Punimet e kryera gjatë ndërtimit dhe funksionimit të

Hidrocentraleve, për kthimin e tij, me shpenzimet e veta, në gjendjen në përparshme sipas detyrimeve të përcaktuara nga Lejet;



- 8.8 Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventalisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo Palëve të Treta;
- 8.9 Të mbajë te informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e Punimeve;
- 8.10 Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjenës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë;
- 8.11 Të mos ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës, sipas miratimit të marrë nga institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve të përdorimit të Ujit. Koncesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit të përcaktuar si rrjedhë ekologjike në shtratin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi sipas miratimit të marrë nga institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve të përdorimit të Ujit. Koncesionari duhet të sigurojë ujin e nevojshëm për vaditje, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjislacionin në fuqi;
- 8.12 Të zbatojë Ligjin në veprimtarinë e tij për implementimin e Objektivit të Koncesionit;
- 8.13 Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9 Investimi

- 9.1 Mbi bazën e të dhënave të studimit të fizibilitetit, investimet që parashikohen të kryhen nga Koncesionari janë në vlerën totale prej 621 368 362 (gjashtë qind e njëzetënjë milion e treqind gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind gjashtëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH, siç detajohet në preventivin bashkëlidhur si Aneksi 2. Ky preventiv përfshin edhe vlerën që do të investohen në makineri e pajisje.
- 9.2 Vlera e mësipërme mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet Palëve:
 - pas variantit përfundimtar të projektit të zbatimit, i cili mund të përmirësohet me kushtin që vlera nuk do të jetë me e ulët se ajo e përcaktuar në pikën 9.1 të këtij neni.
 - në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e Hidrocentraleve;
- 9.3 Vlerësimi i investimit do të bëhet mbi bazën e situacioneve tre mujore, të konfirmuara nga një supervisor i pavarur i zgjedhur nga Koncesionari, dhe i konfirmuar nga Autoriteti

Kontraktues. Situacionet do të jenë të depozituara/deklaruara në organet tatimore sipas ligjit.

Neni 10 Programi Punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të Punimeve:

- 10.1 Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 55 ditëve nga data e pajisjes me te gjitha lejet e nevojshme për fillimin e punimeve te ndërtimit. Fillimi i punimeve do të vërtetohet nëpërmjet një procesverbali të nënshkruar mes palëve. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk merr pjesë në nënshkrimin e këtij procesverbali, atëherë Koncesionari i njofton Autoritetit Kontraktues nisjen e punimeve;
- 10.2 Brenda kuadrit të zbatimit të Punimeve për realizimin e projektit (ligji nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, siç mund të ndryshohet, dhe akteve përkatëse nënligjore, siç mund të shtohen apo zëvendësohen herë pas here), Koncesionari do të caktojë një subjekt në rolin e mbikëqyrësit të Punimeve, i cili do të konfirmohet nga Autoriteti Kontraktues. Ky subjekt mund të jetë një person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
- 10.3 Koncesionari merr përsipër të realizojë Punimet në përputhje me Programin e Punimeve të parashikuar nga Aneksi 3 i kësaj Kontrate Koncesioni.
- 10.4 Palët bien dakord se afati i punimeve do të zgjatet në rastet kur ndodhin Mospërmbushje të Autoritetit Kontraktues, Ngjarje të Forcës Madhore ose Veprime Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme, për një periudhë të njëjtë me Periudhën e Pezullimit të parashikuar nga neni 4.1.2 i kësaj Kontrate Koncesioni.

Neni 11 Komisionimi dhe Vënia në Punë e Veprës

- 11.1 Me përfundimin e punimeve në çdo Hidrocentral, Koncesionari njofton Autoritetin Kontraktues lidhur me situatën dhe kërkon nga ky i fundit pjesëmarrjen në kryerjen e testimit për plotësimin e parametrave teknike sipas Nenit 3 të kësaj Kontrate Koncesioni. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues ose të autorizuarit prej tij dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për plotësimin e parametrave të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 11.2 Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, për secilin Hidrocentral, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

- 11.3 Në përfundim të etapave të mësipërme, Autoriteti Kontraktues duhet të nënshkruajë Certifikatën e Pranimit të Veprës për çdo Hidrocentral, e cila do të konsiderohet e dhënë nëse ky i fundit nuk përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga testimi dhe vënia në punë e secilit Hidrocentral.
- 11.4 Me nënshkrimin e Certifikatës së Pranimit të Veprës për të paktën të njërit prej Hidrocentraleve, apo me kalimin e këtij afati prej 30 (tridhjetë) diteve, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontratën e shit-blerjes së energjisë me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

KREU IV TË NDRYSHME

Neni 12

Mospërbushjet, Forca Madhore dhe Veprimet Shtetërore Thelbësishtë Dëmshme


12.1 Ngjarjet e Mospërbushjes

12.1.1 Në rast të një Mospërbushje nga Koncesionari ose të një Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktues, Koncesionari ose Autoriteti Kontraktues, sipas rastit, do t'i paraqesë Palës tjetër ("**Pala në Mospërbushje**") një njoftim me shkrim duke kërkuar korrigjimin, brenda një afati të arsyeshëm nëse ai është i mundur. Dështimi nga Pala në mospërbushje për ta korrigjuar atë brenda afatit të korrigjimit, do të përbëjë një Ngjarje Zgjidhje sipas kësaj Kontrate Koncesioni.

12.1.2 Në rast të ndonjë Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues, në rast se Koncesionarit i shkaktohet vonese, afati për realizim nën përgjegjësinë e Koncesionarit do të shtyhet me aq kohë sa në mënyrë të arsyeshme do të jetë e nevojshme lidhur me këtë Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktues (duke patur parasysh pasojat e mundshme të vonesës). Gjate kësaj periudhe Koncesionari do të çlirohet nga përgjegjësia për përbushjen e të gjitha detyrimeve që pengohen nga këto Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues.

12.2 Ngjarjet e Forcës Madhore

12.2.1 Palët bien dakord që ato nuk do të kenë të drejtë të ngrenë pretendime për mospërbushje kontraktore sipas kësaj Kontrate Koncesioni ndaj Palës tjetër, apo të pretendojnë dëmshpërblim nga Pala tjetër për humbjet e pësuar, për aq kohë sa këto shkaktohen nga një Ngjarje e Forcës Madhore. Pala përkatëse që nuk mund të përbushë detyrimet e saj për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore, duhet të njoftojë me shkrim Palën tjetër, pa vonesë. Në vijim të ndonjë Ngjarjeje të Forcës Madhore, të dyja Palët do të bëjnë çfarë është e mundur, në mënyrë të arsyeshme, për të parandaluar rritjen apo për të reduktuar pasojat e Ngjarjes së Forcës Madhore, dhe Koncesionari, gjatë gjithë kohës së Ngjarjes së Forcës Madhore, apo pasojave të saj, do të ndërmarrë të gjitha hapat sipas kushteve të rëna dakord të Praktikave të Mira të Industrisë, për të tejkaluar apo minimizuar pasojat e Ngjarjes së Forcës Madhore.



12.2.2 Nëse një Ngjarje e Forcës Madhore ose pasojat e saj vazhdojnë për një periudhë më të gjatë se 3 muaj, duke bërë të pamundur për Palët prekur të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate Koncesioni, atëherë, kjo do të përbëjë një Ngjarje Zgjidhje, të ushtrueshme nga secila Palë sipas nenit 13.3 të kësaj Kontrate Koncesioni.

12.3 Veprimet Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme

12.3.1 Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga ngjarja e një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktues dhe Autoriteti Kontraktues do të sigurojë korrigjimin e Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm në fjalë.

12.3.2 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk do të korrigjojë Veprimin Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm përpara përfundimit të një periudhe prej 90 ditësh nga njoftimi me shkrim i Koncesionarit, Palët do të diskutojnë pa vonesë me qëllim arritjen e një zgjidhje të kënaqshme për të dyja palët për të rivendosur Koncesionarin në pozitën që do të ishte nëse ky Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm të mos kishte ndodhur. Dështimi nga Autoriteti Kontraktues për të korrigjuar apo rivendosur Koncesionarin në pozicionin e mëparshëm, brenda këtij afati (ose nëse Autoriteti Kontraktues ka dështuar apo refuzuar të diskutojë), do të përbëjë një Ngjarje Zgjidhje, të ushtrueshme nga Koncesionari në përputhje me nenin 13.2. Gjate kësaj periudhe Koncesionari do të çlirohet nga përgjegjësia për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që pengohen nga këto Veprime Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme.

Neni 13

Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

13.1 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës së Koncesionit nga Autoriteti Kontraktues, për shkak të Mospërmbushjes së detyrimeve nga Koncesionari.

13.1.1 Autoriteti Kontraktues mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni, për shkak të Mospërmbushjeve të Koncesionarit, të cilat nuk janë korrigjuar brenda një afati 3 (tre muaj), ose një afati tjetër të rene dakord mes Palëve, apo kur Mospërmbushjet e Koncesionarit nuk mund të korrigjohen. Autoriteti Kontraktues nuk mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni në rastet kur ka zbatuar një sanksion, siç parashikohet nga neni 20, dhe sanksioni është shlyer rregullisht nga Koncesionari.

13.1.2 Në rastet e nenit 13.1.1 me sipër, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të njoftojë Koncesionarin dhe Palët Financuese, siç parashikohet në nenin 13.5 për qëllimin e tij për të zgjidhur kontratën, duke i dhënë një afat 60 (gjashtëdhjetë) ditor. Nëse Palët Financuese, brenda këtij afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor, nuk veprojnë në përputhje me të drejtat e tyre, atëherë Autoriteti Kontraktues do të njoftojë zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni, me efekt 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit të këtij njoftimi.

- 13.1.3 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, Koncesionari ka të drejtë për kompensimin e parashikuar nga Aneksi 4a, pa cenuar këtu të drejtën e Autoritetit Kontraktues për të ekzekutuar punën e Kontratës, siç parashikohet nga neni 15.
- 13.1.4 Pas Datës së Zgjidhjes për shkak të Mospërbushjeve të Koncesionarit, Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralet, në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 22.
- 13.2 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës së Koncesionit nga Koncesionari, për shkak të Mospërbushjeve të Autoritetit Kontraktues apo të një Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm
- 13.2.1 Koncesionari mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni për shkak të Mospërbushjeve të Autoritetit Kontraktues të cilat nuk janë korrigjuar brenda një afati 3 (tre mujor), ose një afati tjetër të rene dakord mes Palëve, apo kur Mospërbushjet e Autoritetit Kontraktues nuk mund të korrigjohen. Koncesionari mund të zgjidhë gjithashtu këtë Kontratë Koncesioni në rast të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, që nuk është korrigjuar sipas parashikimeve të nenit 12.3. Në këto raste, Koncesionari, do të ketë të drejtë të njoftojë zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni, me efekt 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit të këtij njoftimi.
- 13.2.2 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, për shkak të Mospërbushjeve të Autoritetit Kontraktues, apo për shkak të një Veprimi Thelbësisht të Dëmshëm, Koncesionari ka të drejtë të kompensohet, sipas parashikimeve të Aneksit 4b.
- 13.2.3 Pas shlyerjes së kompensimit referuar më sipër, nga Autoriteti Kontraktues, atëherë Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralet, në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 22.
- 13.3 Zgjidhja për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore
- 13.3.1 Secila nga Palët mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni në rast të një Ngjarje të Forcës Madhore, e cila zgjat për më shumë se afati i caktuar në nenin 12.2.2, dhe pasojat e të cilës nuk mund të rregullohen nga asnjëra Palë.
- 13.3.2 Në rastet e Nenit 13.3.1 secila Palë do të njoftojë Palën tjetër mbi zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Koncesionit, me efekt të menjëhershëm.
- 13.3.3 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, Koncesionari ka të drejtë për kompensim, siç parashikohet nga Aneksi 4c, për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore.

13.3.4 Pas Datës së Zgjidhjes për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore, Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralet (për pjesën e realizuar, apo të mbetur, në vijim të një Ngjarje të Forcës Madhore), në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 22.

13.4 Zgjidhja e Kontratës me mirëkuptim

13.4.1 Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë Kontratë Koncesioni me mirëkuptim. Me zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni sipas kësaj pike, Koncesionari ka të drejtë të kompesohet, në mënyrën dhe masën e rënë dakord nga negociata të ndërsjella.

13.5 Të Drejtat e Palëve Financuese dhe Zëvendësimi i Koncesionarit

13.5.1 Njoftimi i Palëve Financuese

Autoriteti Kontraktues, në rast të zgjidhjes së kësaj kontrate sipas nenit 13.1 përveç njoftimit të Koncesionarit, njofton edhe Palët Financuese me qëllim dhënien e një mundësie për të ndihmuar Koncesionarin në korrigjimin e mospërmbushjes, ose në marrjen e masave për të rregulluar këto shkelje sikurse është rënë dakord, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

13.5.2 Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se pas ndihmës së ofruar nga Palët Financuese, nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga Koncesionari, atëherë Palët Financuese mund të zgjedhin të ndërhyjnë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues transferimin e projektit në duart e një ekipi manaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues, i cili duhet që të ketë ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit në momentin e këtij zëvendësimi.

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Financuese.

Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra siguroese mbi Hidrocentralet.

Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vazhdimësinë e projektit, Kontrata e Koncesionit do të zgjidhet.

Neni 14 Kontratat

14.1 Koncesionari ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, ka të drejtë të nënkontraktuar në kontrata për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni si dhe legjislacionit ne fuqi.

14.2 Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nën-kontraktuesin e propozuar:

- (a) Emrin e tij dhe adresën;
- (b) Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
- (c) Vlerën e nënkontratës
- (d) Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

14.3 Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.

14.4 Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 15 Sigurimi i Kontratës

15.1 Përpara hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, dhe si Kusht Paraparak i saj, Koncesionari duhet të ketë ngurtësuar për llogari të Autoritetit Kontraktues, pranë një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, të licensuar në Republikën Shqipërisë, vlerën e Sigurimit të Kontratës prej 62,136,836.2 (gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e tridhjetë gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë.2) Lekë, shumë e cila përfaqëson 10 % të vlerës totale të investimit. Forma e sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet kësaj Kontrate Koncesioni si Aneksi 5.

15.2 Koncesionari i ka të drejtë, dhe me kërkesë të tij, Autoriteti Kontraktues do të lejojë ç'ngurtësimin e 80% (tetëdhjetë %) të vlerës së Sigurimit të Kontratës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e nënshkrimit të certifikatës së pranimi të veprës nga Autoriteti Kontraktues, testimi dhe vënies në punë të saj sipas parashikimeve të nenit 11. Ndërkohë, pjesa e mbetur prej 20% (njëzet %) e vlerës së Sigurimit të Kontratës do të ç'ngurtësohet në përfundim të Periudhës së Koncesionit, në përputhje me nenin 4 të kësaj Kontrate Koncesioni.

Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit, kryerjen e testimi dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera të kontratës.

Neni 16 Sigurimi




- 16.1 Koncesionari, në çdo kohë, do të pajiset, mbajë dhe ripërtojë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e te Drejtave Koncesionare të nenit 5, dhe do t'i përcjellë, ose do te kujdeset qe t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e njësuara të çdo certifikatë sigurimi, pas marrjes se një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.
- 16.2 Koncesionari duhet të siguroje punimet e ndërtimit/montimit të Hidrocentraleve dhe më pas Projektin e plotë për gjithë kohëzgjatjen e Kontratës së Koncesionit, të paktën për rreziqet e parashikuara nga legjislacioni për sigurimet (aktualisht Ligji nr. 52/2014 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri-sigurimit”, siç mund të ndryshohet, shtohet apo zëvendësohet herë pas here) gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë çdo vit pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
- 16.3 Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit apo në fazën e operimit të objektit, vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, restauruar dhe për të rikthyer Projektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma qe siguruesi do të paguajë për kompensimin e demit do te përballohet nga Koncesionari.
- 16.4 Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 16.5 Autoriteti Kontraktues do të jetë palë e bashkë-siguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 17 Tarifa Koncesionare

17.1 Tarifa koncesionare

- 17.1.1 Koncesionari do të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesionare të barabartë me vlerën e 2.1% (dy pikë një përqind) të prodhimit vjetor të energjisë elektrike, si dhe të çdo përfitimi tjetër që Koncesionari do të ketë, në përpjesëtim me përqindjen që përfaqëson tarifën koncesionare, nga prodhimi i kësaj energjie elektrike, duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtat që rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave të tjerë në atmosferë.
- 17.1.2 Palët nga nënshkrimi i kësaj Kontrate Koncesioni bien dakord se nëse Koncesionari dështon në arritjen e prodhimit vjetor të paraqitur gjatë Procedurës Përzgjedhëse, si pjesë e ofertës së Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë, tarifa e mësipërme e koncesionit do të jetë e pagueshme duke ju referuar prodhimit vjetor të paraqitur gjatë Procedurës Përzgjedhëse.

17.1.3 Mënyra e pagesës së tarifës së koncesionit do të përcaktohet në marrëveshje ndërmjet Palëve brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate koncesioni.



Neni 18 Kufizimet


- 18.1 Gjatë Periudhës së Koncesionit, Koncesionari do të kontrollohet nga anëtarët e Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë; me kusht, sidoqoftë, që (i) çdo anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë gëzon të drejtën të transferojë lirisht një pjesë apo të gjithë pjesëmarrjen e tij tek Koncesionari, në favor të anëtarëve të tjerë dhe/ose Palëve të Lidhura, në çdo moment; dhe (ii) çdo transferim i një pjese apo të gjithë pjesëmarrjes tek koncesionari apo palet e treta (përfshi një transferim të Kontrollit) do t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga Autoriteti Kontraktues, miratim i cili nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme; me kusht, gjithashtu, që në lidhje me çdo transferim të propozuar në përputhje me pikën (ii) më sipër (përfshi një transferim të Kontrollit), Autoriteti Kontraktues do të marrë në konsideratë eksperiencën, kapacitetin financiar (që do të përfshijë mbështetjen financiare nga palë të treta), qëndrueshmërinë dhe reputacionin e përfituesit të propozuar të transferimit.
- 18.2 Koncesionari nuk do të vendosë barrë, shesë, cedoje apo transferojë në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat dhe detyrimet e tij që lindin ose që rrjedhin nga kjo Kontrate Koncesioni pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues;
- 18.3 Për shmangien e çdo dyshimi, asnjë dispozitë e kësaj Kontrate Koncesioni nuk kufizon të drejtën e Koncesionarit për të vendosur lirisht kolateral sipas kërkesave të Palëve Financuese, për të rifuancuar Projektin, me kusht që të merret paraprakisht miratimi i Autoritetit Kontraktues.

Neni 19 Raportimi

- 19.1 Koncesionari është i detyruar që çdo 3 (tre) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve financiare dhe në natyrë, dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 20 Sanksionet

- 20.1 Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate Koncesioni, penalizon Koncesionarin si më poshtë:
- (a) Koncesionari për çdo ditë vonese në fillimin e punimeve, përtej afatit të parashikuar nga neni 10.1. penalizohet me 10,000 lekë.

- 
- (b) Për shkelje të afatit të perfundimit të ndërtimit të objektit, parashikuar sipas programit të punimeve bashkëlidhur si Aneksi 3, Koncesionari penalizohet me 10,000 lekë për çdo ditë vonese.
- (c) Për moskryerjen totale të investimeve, në vlerën e rënë dakord në nenin 9.1, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të parealizuara.

20.2 Mosarritja e kapacitetit të instaluar dhe mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike sipas kushteve të rëna dakord me këtë Kontratë Koncesioni, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- (i) Në rast se fuqia e instaluar është me e vogël se 90% e kapacitetit të instaluar të planifikuar sipas kësaj Kontrate Koncesioni, Koncesionari do të penalizohet deri në 10% të të ardhurave të pritshme që do të siguroheshin nga energjia elektrike e prodhuar nga kapaciteti i parealizuar (nën 90%).
- (ii) Në rast dështimi për fajin e tij, në arritjen e prodhimit vjetor të paraqitur gjatë Procedurës së Përzgjedhjes, si pjesë e ofertës së Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë (si mesatare e një periudhe 5-vjeçare), Koncesionari do të paguajë në vitin e fundit të çdo periudhe 5-vjeçare, një penaltet të barabarte me 4% të vlerës së prodhimit mesatar të parealizuar. Në rast se Koncesionari nuk e paguan kete penaltet, atehere kjo vlere do t'i mbahet ketij të fundit për llogari të Autoritetit Kontraktues, në sasi të energjise elektrike të prodhuar, nepermjet Entit Publik të Licencuar, nese Koncesionari eshte pjese e skemes mbeshtetese. Në te kundert Autoriteti Kontraktues, rezervon te drejten e heqjes se aksesit te transmetimit te energjise ne rrjetin publik, deri ne kryerjen e pageses.

Në çdo rast, me kryerjen e pageses së penaltetit, dështimi i mosarritjes të prodhimit vjetor nuk përbën kusht për zgjidhje të kontrates.

20.3 Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, siç parashikohet nga neni 8.1 i kësaj Kontrate Koncesioni, e penalizon Koncesionarin me 0.005% të vlerës së investimit për çdo dite vonese.

20.4 Sanksionet paguhen në llogarinë e Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhe 30 ditore lidhur me shkeljen.

20.5 Kur merret një vendim për zbatimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditëve nga data e dhënies së njoftimit. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë edhe kamatat ligjore së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor.

20.6 Zbatimi dhe pagesa e penalteteve sipas këtij neni nuk e çliron Koncesionarin nga përbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.

- 20.7 Këto penalitete, nëse nuk paguhen nga Koncesionari sipas afatit të parashikuar më sipër, do të mbahen nga Sigurimi i Kontratës, parashikuar nga neni 15 i kësaj Kontrate Koncesioni.


Neni 21 **Korrigjimi i Shkeljeve**

- 21.1 Nëse Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë Periudhës së Koncesionit, Koncesionari ka shkelur ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë Kontratë Koncesioni, ai do të informojë menjëherë Koncesionarin mbi këto shkelje dhe do të presë përgjigjen e Koncesionarit, me argumentet përkatëse, për një periudhë prej 40 ditësh, ose të ndonjë afati tjetër të arsyeshëm. Palët nëpërmjet një marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të korrigjohet shkelja.
- 21.2 Kjo procedurë nuk e çliron Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Neni 22 **Transferimi i Aseteve/Dorëzimi**

- 22.1 Me përfundimin e kësaj Kontrate Koncesioni, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin e asetëve dhe çdo titull mbi to tek Autoriteti Kontraktues. Asetet e dorëzuara tek Autoriteti Kontraktues në momentin e dorëzimit të jenë në kushte të mira pune dhe që mundësojnë operimin e tyre për një periudhë të caktuar nga përfundimi i afatit të kontratës.
- 22.2 Me përfundimin e afatit apo zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni:
- Me Dorëzimin e asetëve të Autoriteti Kontraktues, për Koncesionarin, do të përfundojnë automatikisht të drejtat e aksesit, e Drejta e Kalimit dhe Gëzimit të Qetë;
 - Koncesionari do t'i transferojë dhe do t'i kalojë Autoritetit Kontraktues atë pjesë të Punimeve të realizuara deri në atë moment, në rast përfundimi apo zgjidhjeje përpara përfundimit të Punimeve;
 - Koncesionari do t'i dorëzojë dhe do t'i kalojë Autoritetit Kontraktues çdo të drejtë pronësie apo interes mbi Hidrocentralet;
 - Koncesionari do të sigurohet për kalimin e të gjitha garancive në lidhje me Hidrocentralet në favor të Autoritetit Kontraktues.
- 22.3 Proçesi i Transferimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
- 22.4 Me përjashtim të Ngjarjeve të Forcës Madhore, Koncesionari do të dorëzojë asetet në kushte të mira, duke marrë parasysh normën përkatëse dhe amortizimin normal në momentin e dorëzimit.

- 22.5 Çdo e drejtë që Koncesionari ka fituar nëpërmjet kësaj Kontrate Koncesioni, do të përfundojë me transferimin e projektit.
- 22.6 Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga Koncesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të Autoritetit Kontraktues.
- 22.7 Me kryerjen e procedurave të mësipërme të dorëzimit, kur zgjidhja e kontrates behet jo per faj te koncesionarit, Autoriteti Kontraktues do të ç'ngurtësojë pa vonesa vlerën e mbetur te Sigurimit të Kontratës.



Neni 23

Përfundimi i Kontratës së Koncesionit

- 23.1 Kontrata e Koncesionit përfundon me mbarimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh dispozitat e parashikuara nga neni 4 i kësaj Kontrate Koncesioni.
- 23.2 Përfundimi i kësaj Kontrate Koncesioni me mbarimin e afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e çliron Koncesionarin nga detyrimi për të paguar detyrimet e prapambetura kundrejt Autoritetit Kontraktues dhe Palëve të Treta.

Neni 24

Konfidencialiteti

- 24.1 Secila nga Palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me Projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e Palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 25

Ndryshimet

- 25.1 Kjo Kontratë Koncesioni mund të ndryshohet, shtohet dhe/ose zëvendësohet vetëm me marrëveshje me shkrim të të dyja palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 25.2 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate Koncesioni apo Anekseve bashkëlidhur saj do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kontrate.

Neni 26

Bashkëpunimi Midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

- 26.1 Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari zotohen të bashkëpunojnë për të garantuar realizimin e plotë të projektit.

- 26.2 Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet Palëve, do të kryhet, vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë, apo në adresat e përditësuara nga Palët nëpërmjet një njoftimi. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjete) ditor nga data e ndryshimit.
- 26.3 Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues kërkesë me shkrim, për çdo ndihmë që do t'i kërkohet këtij të fundit, në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.
- 26.4 Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate Koncesioni janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr. 1001,
Tiranë - Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria "Idrolusa" Sh.p.k.
Adresa: Njesia Bashkiake nr 2, Rruga
Jeronim De Rada, Ndërtesa 1, Hyrja 25.
Apartamenti 40, Tiranë, Shqipëri,

Neni 27
Legjislacioni i Zbatueshëm

Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.


Neni 28
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 28.1 Çdo konflikt, mosmarrëveshje apo pretendim midis Palëve Kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 28.2 Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i perbashket, kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që lindin në lidhje me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata kompetente për zgjidhjen e konflikteve administrative.
- 28.3 Secila Palë, përveç mjeteve ligjore sipas kësaj Kontrate Koncesioni, do të ketë të drejtën të kërkojë për masa sigurimi pranë gjykatave të cilat kanë juridiksionin.

Neni 29
Regjistrimi i Kontratës së Koncesionit

- 29.1 Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit të zbatimit, Kontrata e Koncesionit duhet të regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

29.2 Kjo Kontratë Koncesioni u hartua në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirisht e të plotë, dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.



PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES
Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Përfaqësuar nga:
Z.Agron Gaxho
Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së
Shërbimeve Mbështetëse

KONÇESIONARI
Shoqëria "Idrolusa" Sh.p.k.
Përfaqësuar nga:
Z. Sokol Muceku
Administrator

